

Mënjanimi i përçarjeve dhe arritja e unitetit sipas rrugës së të parëve fisnikë

Shkroi:

Shejh Salih Suhejmi

Recensoi:

Dr. Salih Fevzan

Anëtar i Komisionit të Përbershëm për Fetva

Përsbtati:

Zejd Haziri

Recensoi:

Dr. Gazmend Mehmeti

Redaktura gjubësore:

Arian Koçi

Ballina:

Avni Gashi

Faqësja:

Agron Hyseni

Shtypi:

“Mileniumi i Ri”, Tiranë

Tirazhi:

250 copë

Botimi i dytë:

1444h / 2023

Shtëpia botuese:

Botimet Udhaebesimtarëve, Tiranë

© *Botimet Urtësia. Të gjitha të drejtat e botimit dhe publikimit të tërsishëm apo të pjesërishtëm, janë të rezervuara dhe të mbrojtura me ligj!*

تتبيه ذوي الأفهام

إلى رَأبِ الصَّدْعِ، والوَنَامِ على منهجِ السَّلَفِ
الكرام

جمع و اعداد

صالح بن سعد السحيمي

تقديم فضيلة الشيخ الدكتور

صالح بن فوزان الفوزان

عضو اللجنة الدائمة للإفتاء و عضو هيئة كبار
العلماء

الترجمة باللغة الألبانية

زَيْدُ بن أنور حَزِيرِي

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Falënderimi i takon vetëm Allahut, lutjet dhe bekimet qofshin mbi Pejgamberin tonë Muhamed, i cili na la në rrugë të qartë dhe tha: “Unë po u lë juve diçka, që nëse kapeni për të, nuk do të devijoni pas meje kurrë: Librin e Allahut dhe Sunetin tim”.

Kjo realizohet duke iu përmbajtur metodologjisë së umetit të Muhamedit, në të cilën janë selefus salih, prej sahabëve dhe tabiinëve, dhe duke braktisur gjërat që e kundërshtojnë këtë metodologji, siç janë pikëpamjet, mendimet, grupimet dhe xhematet e ndryshme.

Kjo zbatohet duke e njohur metodën e atyre që ecnin sipas kësaj rruge, pastaj duke iu përmbajtur asaj me dije, siç ka thënë i Lartësuar: **“Allahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) dhe prej ensarëve (vendasve-ndihmëtarë) dhe prej atyre që i pasuan ata me punë të mira, e edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij”**. (Et Tevbe: 100)

Unë e lexova këtë libër të shejh dr. Salih bin Sead Suhejmit, i cili përmban nxitjen për njohjen e kësaj metodologjie, të përmbajturit asaj dhe lënien e kundërshtimeve dhe përçarjes. Allahu e shpërbleftë me të mira dhe sjelltë dobi me atë që shkroi dhe sqaroi, nën titullin “Tenbihu dhevil efham”.

Salatet dhe selamet qofshin mbi Pejgamberin tonë Muhamed dhe mbi familjen dhe shokët e tij.

Shkroi:

Salih bin Fevzan el Fevzan

Anëtar i Komisionit të Dijetarëve të Mëdhenj

Më 14/7/1436 h

Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit!

Falënderimi i takon Allahut vetëm, lutjet dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Pejgamberin tonë Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij.

Shejhu ynë i nderuar, dijetari i madh shejh Abdulmuhsin bin Hamed El-Abbad El-Bedër ka shkruar një libër për të bashkuar ndjekësit e selefit dhe për të sqaruar qëndrimet e dijetarëve përballë atyre dijetarëve që kanë bërë ndonjë gabim duke e titulluar: “O pasues të Sunetit, silluni butë me ehlu sunetin”, ku i këshilloi vëllezërit e vet dhe bijtë e tij me bashkim dhe afrim të fjalës dhe mos ngutje në nxjerrjen e dispozitave ndaj vëllezërit të tyre.

Pas disa vitesh ai nxori një fjalë tjetër me titull: “Dhe sërish: O pasues të Sunetit, silluni butë me pasuesit e Sunetit”.

Ashtu siç botoi edhe vëllai ynë, thirrësi i njohur shejh Bedër bin Alij El-Utejbi një shkrim të suksesshëm me titull: “Mëshironi selefizmin, se vërtet nga ju ka të atillë që largojnë (të tjerët me sjelljen e tyre)”.

Me këtë rast edhe unë po them: O pasues të Sunetit, silluni butë me pasuesit e Sunetit!

Dhe gjithashtu po them: Mëshironi selefizmin, në këtë shkrim të shkurtër, duke shpresuar që Allahu t’i bëjë dobi me të atij që e përmbloodhi, lexuesit, kërkuesve të dijes dhe të gjithë muslimanëve të tjerë.

Në fillim të këtij shkrimi po ia përkujtoj vetes dhe vëllezërve të mi nga ehlu suneti në përgjithësi dhe nga kërkuesit e dijes selefti në veçanti këto citate:

Allahu –qoftë i lavdëruar dhe i lartësuar- thotë: **“O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos u shtyjë urrejtja ndaj një populli e t’i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë se ajo është më afër devotshmërisë!”** (El Maide: 8)

“Kur të flitni (*të dëshmoni*), duhet të jeni të drejtë!” (El Enam: 152)

“O ju që besuat! Ta keni në kujdes Allahun dhe të jeni me ata të drejtët!” (Et Tevbe: 119)

“Mos iu qas asaj për të cilën nuk kë njohuri, vërtet të dëgjuarit, të parët dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi.” (El Isra: 36)

“(Robërit e Zotit janë) Edhe ata që nuk dëshmojnë rrejshëm dhe kur (*rastësisht*) kalojnë pranë së keqes, kalojnë duke e ruajtur karakterin e vet.” (El Furkan: 72)

Gjithashtu thotë: **“O ju besimtarë, përmbajuni mësimëve të Allahut dhe thoni fjalë të drejta. Ai (*Allahu*) ju mundëson të bëni vepra të mira, ju shlyen mëkatet tuaja, e kush respekton Allahun dhe të dërguarin e Tij, ai ka arritur një sukses të madh.”** (El Ahzab: 70-71)

“O ju që keni besuar, largohuni prej paragjykimeve të shumta, meqë disa paragjykime janë mëkat dhe mos hulumtoni për zbulimin e të metave të njëri-tjetrit, dhe mos përgjoni njëri-tjetrin; a mos ndonjëri prej jush dëshiron të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur? Atë pra e urreni!” (El Huxhurat: 12)

“Ne e kemi krijuar njeriun dhe dimë se ç’pëshpërit ai në vetvete dhe Ne jemi më afër tij se damari (*që rrah*) i qafës së tij. Dhe se kur dy engjëjt qëndrojnë pranë tij në të djathtë dhe në të majtë. Që ai nuk hedh ndonjë fjalë e të mos jetë pranë tij përcjellësi i gatshëm.” (Kaf: 16-18)

“Mos e respekto askënd që betohet shumë dhe është i përçmuar, që është përgojues e bën fjalë ndër njerëz, të ashprit që, veç kësaj është edhe fëmijë i jashtëligjshëm.” (El Kalem: 10-12)

Dhe thotë –qoftë i lavdëruar dhe i lartësuar: “**Mjerë për secilin që ofendon e përqesh** (*njerëzit!*)” (El Humeze: 1)

I Dërguari i Allahut, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Kush beson Allahun dhe Ditën e Fundit, le të flasë mirë ose le të heshtë”. Transmetojnë Buhariu (6018) dhe Muslimi (47) nga Ebu Hurejra, radijAllahu anhu.

Ai ka thënë gjithashtu: “Kush më garanton mua atë që gjendet mes nofullave (gjuhën nga gjynahet e saj) dhe mes këmbëve (organin nga zinaja), unë ia garantoj atij xhenetin”.

Transmeton Buhariu (6474) nga Sehël ibën Seadi, radijAllahu anhu.

Dhe: “Vërtet robi flet me fjalë që hidhërojnë Allahun, pa i kushtuar vëmendje asaj, por me të futet në xhehenem”. Transmeton Buhariu (6478) nga Ebu Hurejra, radijAllahu anhu.

Në një transmetim: “Ja shkruan Allahu atij për shkak të saj hidhërimin e Tij deri ditën kur ta takojë Atë” e transmeton Maliku në “Muvata” (2072), Taberani në “El Muaxhemul Kebir” (1134), nga Bilal bin Harith el Muzenij, radijAllahu anhu, dhe Albani e saktësoi në “Es Sahiha”, 888.

Ai, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i tha Muadhrit, radijAllahu anhu: “Ndale këtë!” dhe bëri me shenjë kah gjuha. Ai tha: “O i Dërguar i Allahut! Edhe për atë që flasim, do të llogaritemi?” I tha: “Mos të pastë nëna, o Muadh, po a ka diçka që i fut njerëzit në zjarr me fytyrë veçse të korrurat e gjuhëve të tyre?!” Transmetojnë Ahmedi në “Musned” (22063), Ibën Maxheh (3973), Tirmidhiu (2616) dhe të tjerët.

Ai, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, gjithashtu ka thënë: “I mjafton njeriut si gënjeshtër kur ai flet me çdo gjë që dëgjon”. Transmeton Muslimi në “Mukadime” (1/10) nga Ebu Hurejra, radijAllahu anhu.

Gjithashtu ai, sal-lAllahu alejhi ve selem, ka thënë: “Ruajuni nga paragjykimet, se vërtet paragjykimet janë fjalët më të

rreme!” Transmetojnë Buhariu (5143) dhe Muslimi (2563) nga Ebu Hurejra, radijAllahu anhu.

Dhe: “Sa zakon i keq i dikujt është ai që flet me paragjykime (kanë thënë)”. Transmetojnë Ahmedi, Buhariu në “Edebul mufred” (763), Ebu Davudi (4972) dhe të tjerët, kurse Albani e saktësoi në “Es Sahiha”, 866.

Dhe gjithashtu: “Nuk është i fortë ai që tregohet i fortë në mundje, por i forti është ai që përmban veten kur zemërohet¹”.

Kur dikush i kërkoi një këshillë, Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i tha: “Mos u hidhëro!”², dhe e përsëriti tri herë.

Kurse Aliu, radijAllahu anhu, ka thënë: “Mos u bëni njerëz të ngutshëm e euforikë (prijës në të keqen), përhapës të lajmeve (pa i vërtetuar-spekulues dhe pa e shikuar dobinë e përhapjes), farë e fitnes (të keqes, me bartje të fjalëve, nxitjes së urrejtjes e armiqësisë mes muslimanëve)!³”

¹ Transmetojnë Buhariu (6114) dhe Muslimi (2609) nga hadithi i Ebu Hurejrës.

² Transmeton Buhariu në “Sahihun” e tij (6114) nga hadithi i Ebu Hurejrës, radijAllahu anhu.

³ Transmetojnë Buhariu në “Edebul mufred” (327), Ebu Davudi në “Zuhd” (146), Ibën Ebi Shejbeh në “Musanef” (34540), Ibnul Mubarek në “Ez Zuhdu ver Rekaik” (1438) nga Ibni Mesudi, radijAllahu anhu, dhe e saktësoi Albani nga Aliu, radijAllahu anhu, në “Sahih Edebil mufred” (250).

Pas leximit të këtyre teksteve të bekuara që urdhërojnë për ruajtjen e gjuhës, ndalimin nga çdo gjë e pahijshme dhe preokupimin e saj me dije të dobishme dhe përmendjen e Allahut –qoftë i lavdëruar dhe i lartësuar- si dhe mbrojtjen e saj nga sharja, ofendimi, thumbimi me fjalë e me gjeste, përgojimi dhe bartja e fjalëve, nëse ka ndonjë vërejtje të arsyeshme, kjo duhet të sqarohet me urtësi dhe maturi, me metodë të mirë pa sharje e ashpërsi. Allahu i Lartësuar thotë: “**...dhe njerëzve u thoni fjalë të mira**” (El Bekare: 83), dhe: “**...andaj, (të keqen) ktheje në mënyrën më të mirë**” (Fussilet: 34), si dhe: “**...dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira**”. (En Nahël: 125). Po e them sërish: O ndjekës të Sunetit, silluni butë mes vete dhe mëshironi davetin selefi!

Vlera e thirrjes në Allah

Çdo musliman e ka të qartë se thirrja në Allahun e Lartmadhëruar është pozita më e ndershme dhe detyra më sublime, por edhe më e mira udhë që të afron tek Allahu i Lartësuar, ashtu siç thotë Ai: **“E kush është në rrugë më të mirë se ai që thërret në rrugën e Allahut, që bën vepra të mira dhe që thotë: “Unë jam prej muslimanëve”?”** (Fussilet: 33)

Thirrja në Allah ishte detyrë e Pejgamberëve dhe e të Dërguarve. Allahu i lartësuar thotë: **“Thuaj: Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras te Allahu, unë dhe ai që vjen pas meje. Larg të metave është Allahu, e unë nuk jam nga idhujtarët”**. (Jusuf: 108).

Si dhe: **“Nga ju le të jetë një grup që thërret në atë që është e dobishme, urdhëron për punë të mbara dhe ndalon nga e keqja. Të tillët janë ata të shpëtuarit.”** (Alu Imran: 104)

Thirrësi në Allah duhet të flasë me dituri, të jetë njohës i gjendjes së atyre që i thërret, të dijë ç’të thotë dhe kur ta thotë, duke pasur maksimalisht në konsideratë urtësinë, pasojat, pengesat, butësinë dhe mëshirën duke pasuar të Dërguarin tonë, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ku Allahu i Lartësuar e cilësoi atë me fjalën e Tij: **“Ti ishe i butë ndaj tyre me mëshirën e Allahut, e sikur të ishe i vrazhdë e zemërfortë, ata do të largoheshin prej teje”**. (Alu Imran: 159), dhe me fjalën e Tij: **“Juve ju erdhi i Dërguar nga lloji**

juaj, atij i vjen rëndë për vuajtjet tuaja, sepse është i kujdesshëm dhe insistues në udhëzimin tuaj, është i ndjeshëm dhe i mëshirshëm për besimtarët”. (Tevbeh: 128)

Sa madhështor është udhëzimi i Allahut për dy Pejgamberët e tij fisnikë, Musain dhe Harunin, alejhimas salatu ves selam, në mënyrën e të folurit dhe thirrjes së jobesimtarit më inatçi dhe mohues në atë kohë, që ishte faraoni, kur Allahu i Lartësuar u tha Musait dhe Harunit: **“Shkoni që të dy te faraoni, se ai vërtet e ka tepruar. Atij thojini fjalë të buta, ndoshta ai mendohet a frikësohet”**. (Ta ha: 43-44). Po ashtu medito për fjalën e të Dërguarit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, për kurejshitet në ditën e çlirimit: “Po them ashtu si ka thënë vëllai im Jusufi: **“Sot nuk ka qortim kundër jush, Allahu ju faltë ju; Ai është më i mëshirshmi ndër mëshiruesit.”**⁴ (Jusuf: 92). Kurse Enes ibën Maliku, radijAllahu anhu, ka thënë: “I kam shërbyer të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, për dhjetë vite, pasha Allahun kurrë nuk më ka thënë: ah! E as nuk më ka thënë për ndonjë gjë: Pse e bëre kështu, ose sikur ta kishe bërë kështu⁵”.

O vëllezërit e mi thirrës dhe kërkues të dijes, lexojini këto tekste, meditonit dhe kuptojini, punoni me to dhe zbatoni udhëzimet e tyre fisnike për kërkuesit e dijes!

⁴ Transmetojnë Nesaiu në “Sunen el Kubra” (11234), Bejhakui në “Sunen el Kubra” (18275), Tahaviu në “Sherh Meanil Athar” (5454) dhe të tjerët nga Ebi Hurejra, radijAllahu anhu.

⁵ Transmeton Muslimi në “Sahihun” e tij (2309) nga Thabit el Bunjani, rahimehullah.

Përsosmëria e kësaj feje

Allahu i Lartësuar tashmë na ka fisnikëruar me Islam dhe e ka bërë fe që nuk pranon rivalitet, ka vendosur në të sqarimet e besimit, adhurimit, dispozitave, moraleve dhe marrëdhënieve të ndërsjella, që sikur të kapeshim për to, do të lumturoheshim në të dyja botët. Kjo përsosmëri e fesë nga Allahu i Lartësuar për umetin ka ndodhur para së ndërronte jetë i Dërguari, sal-lAllahu alejhi ve selem. Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj”**. (El Maide: 3). Kurse hebrejtë i thanë Umerit, radijAllahu anhu, për këtë ajet: “Në librin tuaj është një ajet, që e lexoni. Sikur të na ishte shpallur neve, atë ditë do ta shpallnim festë”. Ai tha: “Cili ajet është ky?” Thanë: **“Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjodha që Islami të jetë feja juaj”**. Umeri tha: “E dimë atë ditë, si dhe vendin kur i është shpallur Pejgamberit, alejhi selam, kur ai ishte në këmbë në Arafat, në ditën e xhuma⁶⁷”.

Allahu i Lartësuar po ashtu ka thënë: **“Kush kërkon fe tjetër përveç Islamit, nuk do t’i pranohet dhe ai në botën tjetër do të jetë i humbur”**. (Alu Imran: 85)

⁶⁷ Transmetojnë Buhariu (45) dhe Muslimi (3017).

Ku të kthehemi gjatë mosmarrëveshjeve

Allahu i Lartësuar na ka nderuar me dy shpalljet (Kuranin dhe Sunetin), prandaj gjatë mosmarrëveshjeve duhet të kthehemi tek ato, që gjatë kundërshtimeve të gjykojmë me to, meqë Allahu i Lartmadhëruar na ka urdhëruar që për çdo kundërshtim të kthehemi te Libri i Tij dhe Suneti i të Dërguarit të Tij, sal-lAllahu alejhi ve selem.

Allahu i Lartësuar thotë: **“O besimtarë! Bindjuni Allahut, bindjuni të Dërguarit dhe atyre që drejtojnë punët tuaja. Nëse nuk pajtoheni në ndonjë gjë, kthehuni te Allahu (Libri i Tij) dhe tek i Dërguari (Suneti), nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit. Kjo është më e mira për ju dhe shpjegimi më i bukur”**. (Nisa: 59). Muxhahidi, rahimehullah, ka thënë: “Nëse dijetarët kanë mospajtime, kthejuni Allahut dhe të Dërguarit, pra Librit të Allahut dhe Sunetit të të Dërguarit të Tij, sal-lAllahu alejhi ve selem”, pastaj lexoi fjalën e Tij: **“...e sikur t’ia linin për shqyrtim të Dërguarit dhe parisë, hulumtuesit do të dinin të nxirrnin përfundime”**. (En Nisa: 83)

Allahu i Lartësuar thotë: **“Për çfarëdo gjëje që ju të kundërshtoheni, fjala e fundit i përket Allahut”**. (Shura: 10). Ai na ka urdhëruar që t’i nënshtrohemi Atij dhe të Dërguarit të Tij, sal-lAllahu alejhi ve selem, më pas vjen nënshttrimi ndaj drejtuesve brenda kufijve të nënshttrimin ndaj Allahut të Lartësuar dhe pastaj na ka drejtuar që t’i drejtohem Atij dhe të Dërguarit të Tij kur kemi mospajtime,

pra t'i kthehemi Librit të Allahut dhe Sunetit të Dërguarit të Tij, sal-Allahü alejhi ve selem, bile e ka kushtëzuar saktësinë e besimit me fjalën e Tij: **“...nëse besoni Allahun dhe Ditën e Kiametit”**. Ibën Ebil Izzi el Hanefij, rahimehullah, ka thënë: “Për çështjet në të cilat umeti ka mosmarrëveshje – qoftë në bazamente apo në degë- nëse nuk kthehen tek Allahu dhe i Dërguari, sal-Allahü alejhi ve selem, kurrë nuk do të qartësohet e vërteta, përkundrazi diskutuesit zhyten edhe më shumë në mosmarrëveshjet e tyre. Nëse i mëshiron Allahu, do t’ia njihnin njëri-tjetrit vlerën dhe nuk do t’i bënin padrejtësi njëri-tjetrit, ashtu siç ishin sahabët –Allahu qoftë i kënaqur me ta- nën drejtimin e Umerit dhe Uthmanit, kur diskutonin për disa çështje të ixhtihadit, megjithatë e miratonin njëri-tjetrin dhe nuk i bënin padrejtësi njëri-tjetrit.

Nëse nuk i mëshiron, mes tyre do të ndodhin kundërshtime të urryera, do ta shtypin njëri-tjetrin, qoftë me fjalë duke e nxjerrë nga feja ose duke e shpallur si fasik (mëkatar), apo me vepra duke e burgosur, rrahur apo edhe vvarë.

Ata që i testuan njerëzit me bidatin e krijimit të Kuranit ishin prej këtij grupi (që u cek tani), të cilët shpikën bidate dhe shpallën si të pafe kundërshtarët e tyre dhe ia lejuan vetes mosdhënien e hakut kundërshtarit dhe dënimin e tij. Kur njerëzit nuk e kanë të qartë një pjesë të asaj me të cilën Allahu e ka dërguar të Dërguarin e Tij, sal-Allahü alejhi ve sel-lem, ose tregohen të drejtë ose zullumqarë; i drejti i tyre është ai që punon me gjurmët e Pejgamberëve që ai di dhe nuk u bën padrejtësi të tjerëve, ndërsa zullumqari është ai që

i shtyp të tjerët, edhe pse shumica e tyre bëjnë padrejtësi me vetëdije sepse janë shtypës, siç thotë i Lartësuari: **“Ata të cilëve u është dhënë libri, patën mospajtime nga zilia që kishin midis tyre, vetëm pasi u erdhi dituria”**. (Alu Imran: 19). Sikur t'i përmbaheshin asaj që dinin nga drejtësia, do ta vlerësonin njëri-tjetrin siç bëjnë imituesit me njerëzit e dijes, të cilët e dinë hallin e vet se janë të paaftë për njohjen e vendimit të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij në ato çështje e kështu i konsideruan imamët e tyre zëdhënës të të Dërguarit dhe thanë: -Kjo është maksimumi që mund të bëjmë. I drejti i tyre nuk i bën padrejtësi tjetrit, as nuk i bën zullum me fjalë apo me vepra, si shembulli i atij që pretendon se fjala e personit që ndjek me imitim është e saktë, edhe pse nuk sjell ndonjë argument, si dhe e qorton kundërshtarin e tij, por ky është i arsyetuar⁷”.

⁷ “Sherhut Tahavije”, fq. 528-529, botimi i Evkaf Suudije.

Konfirmimi, maturia dhe mosnxitimi janë obligim në nxjerrjen e vendimeve për njerëzit

Disa njerëz e kanë zakon të nxjerrin gjykime për vëllezërit e tyre në nxitim e sipër padrejtësisht, pa i konfirmuar gjërat e pa i menduar, ose e gjykojnë tjetrin se është inovator, mëkatar apo i dalë prej feje dhe e shohin obligim bojkotin e tij dhe e nxjerrin nga selefizmi. Ata paralajmërojnë nga disa dijetarë e kërkues dije selefij apo përpiqen për rrëzimin të tyre për shkak të ndonjë sëmundjeje që vetë këta e kanë ose për shkak të tekave që kanë mbuluar të menduarit e tyre, ose për shkak të ndonjë smire që ua ka kapluar logjikën ose mbështeten në ndonjë transmetim që pandehin se është nga njerëzit besnikë, kur ata në realitet janë të zotët e trazirave dhe shkaqet e përçarjes.

Selefizmi nuk është me teprime dhe ngutje në kritika të pastudiuara, as me përcjellje të gabimeve dhe kushtëzim të njerëzve me atë që nuk kushtëzohen e as me këputje të fjalëve dhe mosinterpretimin e mirë të tyre apo me hedhje poshtë të disave me pretekstin e lajmeve të sakta, as me fanatizëm ndaj personaliteteve ose me kufizim të vendimit për të tjerët në persona të caktuar, as me nxitim në kundërshtim ndaj atij që ka gabuar para se të këshillohet, as me preokupim për të gjykuar me bidat, mëkat e pabesim pa i vërtetuar gjërat, as me paragjykim dhe ngutje në pranimin e lajmeve dhe përhapjen e tyre pa i logjikuar pasojat dhe përfundimet para se të nxirren gjykimet.

Allahu i Lartësuar thotë: **“E ata që fyejnë besimtarët dhe besimtare, për çka ata nuk janë fajtorë, ata kanë ngarkuar veten me një mëkat shumë të madh”**. (El Ahzab: 58)

Në hadith transmetohet: “Kush thotë për një besimtar një të pavërtetë, Allahu do ta vendosë te shkrirjet⁸ e trupave të xhehenemlinjve (dhe nuk e nxjerr nga aty), veçse nëse pendohet⁹”. Dhe po ashtu: “Vërtet që kamata më e madhe është prekja e nderit të muslimanit pa kurrfarë të drejte¹⁰”.

Kini frikë Allahun o kërkues të dijes dhe mos u bëni mjet shkatërrimi që futet në eshtrat e thirrjes (davetit) dhe e devijon rrugën e vet e pastaj përçan selefitë në grupe dhe fraksione të reja!

⁸ Lëngu i trupave të djegur, ku rrjedh aty.

⁹ Transmeton Ahmedi në Musnedin e tij (5385), Ibën Maxheh në Sunenin e tij (3377), Hakimi në Mustedrek (2222) dhe të tjerët nga Abdullah ibën Umeri, radijAllahu amhu, dhe e saktësoi Albani në “Sahihut terğib” (2845).

¹⁰ Transmeton Ahmedi në Musnedin e tij (1651), Ebu Davudi në Sunenin e tij (4876), Bejhakui në “Shuabul iman” (6284) dhe të tjerët nga Seid ibën Zejdi, radijAllahu anhu, dhe e saktësoi Albani në “Sahihul Xhami’ë” (2203).

Shembuj të gjykimeve të padrejta në këtë metodologji të re

1) Njëri prej tyre ka pretenduar në disa adresa interneti se dy dijetarët, shejh Muhamed bin Salih el Uthejmin dhe shejh Abdulmuhsin El Abbad el Bedër, janë dy dijetarë prej të cilëve përfitohet në fushën e sunetit, hadithit dhe fikhut, por nuk duhen pyetur për metodologjinë dhe njerëzit (burrat) me pretekstin se çdo shkencë ka të zotët e vet dhe ka prej dijetarëve që nuk janë të ditur në njohjen e metodologjisë së selefit dhe vlerësimin e metodologjive të importuara, porse kjo i përket vetëm filanit e fistekut!

Unë mendoj se dijetarët që u apostrofuan prej tyre nuk janë të kënaqur me këtë konkluzë të padrejtë ndaj dijetarëve të tjerë e as nuk e pëlqejnë atë propozim. Kjo më kujtoi pretendimin e njërit prej kokave të partiakëve te ne para njëzet vitesh, kur dijetarët tanë i përshkroi se nuk e kuptojnë aktualitetin dhe se grupet e thirrjes bashkëkohore janë ato që i kuptojnë rrethanat e muslimanëve dhe planet e armiqve dhe se kjo u përket vetëm atyre (grupeve)!

Ashtu sikurse më kujton njërin para më shumë se njëzet vitesh, kur kishte thënë: “Nuk dëshirojmë dijetarë të moçëm e të ngurtë”, dhe më pas cilësoi mësuesin tonë Muhamed Emin Shenkitin (rahimehullah) si një mjet incizimi (!) që i ruan sendet që ka brenda pa marrë pjesë në zgjidhjen e problemeve!

Për këtë arsye po them: E kemi obligim që të kemi frikë Allahun dhe t'i respektojmë dijetarët tanë, që t'ua japim pozitën e merituar, ngase akuzimi i tyre padrejtësisht i trimëron armiqtë e Islamit dhe të umetit për ta dëmtuar Islamin.

2) Të ngutshmit si këta janë këmbëngulës në paralajmërimin kundër disa dijetarëve dhe kërkuesve të dijes, selefij të ndershëm –me qëllim të uljes poshtë dhe prishjes së imazhit të tyre- kur ata ftohen nga ndonjë shoqatë apo organizatë për të mbajtur mësimë apo seminare shkencore, posaçërisht kur ftohen në vendet e Perëndimit dhe pakicat muslimane në Evropë apo Amerikë. Ata njerëz atje kanë nevojë për dikë që t'ua mësojë besimin e drejtë dhe rregullat e adhurimit, meqë ka prej tyre që nuk e dallojnë dot as tevhidin nga idhujtaria, kurse disa sapo e kanë pranuar Islamin. E këta (të ngutshëm) i preokupuan ata me këtë kategorizim abuziv dhe paralajmërim (dëgjoni filanin e mos e dëgjoni fistekun), kurse në selefizmin e personit për të cilin paralajmërohet nuk ka kurrfarë dyshimi. Ose thonë se rekomandimi i kufizuar merret vetëm nga disa dijetarë, që numërohen në gishta, dhe kush ju vjen me rekomandime nga ata, pranojeni dhe dëgjojeni, madje rregullojeni kushtet për të dhënë mësimë dhe seminare shkencore, kurse kush vjen me të tjera rekomandime, shmanguni, paralajmëroni nga ai dhe refuzojeni...

E vërteta është se kjo metodologji fraksioniste dhe e ngushtë ka prodhuar ndasi, fraksione dhe divergjenca mes njerëzve të

një rrugë, bile ka prodhuar edhe “myfti” të vegjël, qofshin edhe nga ata që janë të rinj në Islam, dhe ka ardhur puna që të tillët të bëhen gjykatës për dijetarët dhe kërkuesit e dijes selefij. Kjo punë shkoi aq larg, saqë u bë pengesë në rrugë të Allahut –qoftë i lavdëruar dhe i lartësuar-, i la ato pakica islame në injorancën e tyre, u përhap kaosi dhe ndarja mes tyre, bile prej tyre kishte të atillë që i drejtuan armët njëri-tjetrit edhe pse jetonin në vende të kufrit. Gjithashtu kjo metodologji ishte shkaktare që të ndaleshin shumë mësimë dhe seminare shkencore akademike, meqë të rinjtë u preokupuan kundër njëri-tjetrit në ato vende, duke shpallur bidatçinj njëri-tjetrin, duke konsideruar mëkatarë njëri-tjetrin apo edhe duke e nxjerrë nga feja njëri-tjetrin! Ata e braktisën dijen dhe u morën me thashetheme, u dobësua tek ata adhurimi dhe devotshmëria e prej tyre kishte edhe disa që nuk e falnin namazin me xhemat, por u bindën (nga kokat e tyre) që të kategorizonin vëllezërit e tyre, duke u mashtruar se ishin dijetarë të mëdhenj e të pagabueshëm dhe se puna e tyre kryesore ishte kategorizimi i dijetarëve dhe i kërkuesve të dijes dhe paralajmërimi prej tyre. E të mos flasim për sëmundjen e mendjemadhësisë, arrogancës, vetëmashtrimit dhe vetëpëlqimit që i ka goditur këta persona...!

Dëshmi e kësaj që thamë është ky llum i madh që shkruajnë ata nëpër faqet e internetit dhe rrjetet sociale me emrat e tyre të qartë ose me llagape të fshehura. Andaj, kini frikë Allahun e mos u bëni pengesë në rrugë të Allahut, mos shpifni për vëllezërit tuaj dhe fjalët e tyre interpretojini me kuptimin më

të mirë –siç është metodologjia e selefit- dhe mbroni nderin e tyre!

Kërkuesi i dijes selefij është ai që bashkon dhe nuk përçan, që i bashkon njerëzit në udhëzimin e Kuranit dhe Sunetit. Këtu nuk është për qëllim vetëm bashkimi që ndjekin partiakët, por ai përpiqet maksimalisht për bashkimin e vëllezërve të vet në ndjekjen e së vërtetës dhe në rrugën e drejtë, rrugë në të cilën nuk ka as teprim e as neglizhencë. Po ashtu ai duhet përgëzuar dhe jo larguar, duke pasur para syve të tij gjithmonë frikën e Allahut dhe devotshmërinë ndaj Tij, në mënyrë që të mos jetë nga të falimentuarit (në Ditën e Gjykimit) për shkak të padrejtësisë së tij ndaj vëllezërve të vet.

I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “A e dini se kush është i falimentuari?” Ata thanë: “I falimentuari te ne është ai që nuk ka as dërmë e as mall”. Ai tha: “I falimentuari nga umeti im është ai që vjen në Ditën e Kiametit me namaz, agjërim dhe zekat, por njëherazi ka sharë filanin, e ka akuzuar pa fakte fistekun, ka ngrënë pasurinë e atij, ka derdhur gjakun e atij, filanin e ka rrahur. Atëherë, të mirat e tij i jepen atij e atij dhe kur t’i harxhohen të mirat para se të gjykohet, atëherë atyre u merren të këqijat dhe i ngarkohen këtij, e pastaj hidhet në zjarr”¹¹.

¹¹ Transmeton Muslimi në Sahihun e tij (2581) nga Ebu Hurejra, radijAllahu anhu.

Shkaqet kryesore të divergjencës mes ndjekësve të një metodologjie dhe rrugët e shërimit

Shkaqet kryesore të divergjencës

Vrojtuesi në davetin selefij rreth asaj që po ndodh mes disa dijetarëve dhe kërkuesve të dijes prej bojkoteve dhe lëçitjeve, përplasjeve dhe refuzimeve komike – *që i gëzon armiqët e Islamit ashtu siç gëzohen armiqët e Sunetit dhe xhematet e fraksionet e tjera të shumta kundërshtuese të metodologjisë së selefit dhe është shkaktare për largimin e rinisë nga kërkimi i dijes apo i lajthitjes së tyre nga qëndrueshmëria në fe-* vjen në përfundimin se shumica e shkaqeve janë tepër të dobëta apo ndoshta mund edhe të mos jenë shkaqe të vërteta fare, por në realitet pas studimit janë shkaqe të rreme që nuk mbështeten në asnjë dëshmi sheriatike, janë të ndërtuara në imagjinatat e mendjes, të shpikura dhe që nuk kanë ekzistencë në realitet. Sa për ilustrim po përmend disa:

1) Përplasia mes civateve të Kuranit dhe Sunetit ose përplasia mes fjalëve të selefit dhe mosbashkimi i fjalëve të tyre të thëna në një çështje të caktuar. E kjo është injorancë me *mubkem* dhe *muteshabih*¹² nga Kurani dhe Suneti si dhe me disa fjalë të selefit. Dikush nga ata qëllimisht sjell vetëm disa thënie të selefit në një çështje të caktuar dhe nuk e bën

¹² Muhkem: koncize apo të qarta, muteshabih: jokoncize; për më shumë rreth këtij lloji të ajeteve shih komentin tonë të librit “Mbi rrugën e të parëve tanë” fq.34-39 të shejh Abdulkadër Arnautit, rahimehullah. (sh.p.).

bashkimin e tyre në tërësi në atë çështje (përmend diçka, por i ikin shumë gjëra të tjera), duke bartur fjalë nga këtu e nga aty dhe pastaj i zbaton mbi vëllanë (shokun) e vet, e ndoshta edhe e shpall si risimtar apo gjynahqar apo edhe e nxjerr nga selefizmi(!), por ai nuk ka përfshirë në atë çështje krejt metodologjinë e selefët e as nuk i ka cituar citatet e tjera kundërshtuese nga selefët e tjerë. Allahu, qoftë i lavdëruar dhe i lartësuar, na ka paralajmëruar prej kësaj metode ashtu si na ka paralajmëruar edhe i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, prandaj ehlu suneti dhe xhemati shikojnë të gjitha citatet e selefët dhe të gjitha veprat e tyre sepse Allahu nuk e ka përcaktuar pagabueshmërinë vetëm në njërin prej tyre e as në dy prej tyre, por pagabueshmëria është në umet si tërësi. Kështu që Pejgamberi, alejhi selam, ka thënë: “Njerëzit më të mirë janë shoqëruesit e mi, pastaj ata që vijnë pas tyre dhe pastaj ata që vijnë pas tyre”¹³, prandaj ai mirësinë absolute e ka përcaktuar tek umeti si tërësi e jo tek individët.

I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Vërtet Allahu e ka mbrojtur umetin tim që të bashkohet në devijim¹⁴”, por disa “të shtirur si të dijshëm” gjejnë fjalë dhe i gjykojnë të tjerët në bazë të asaj fjale dhe i shpallin të lajthitur ata që i kundërshtojnë, qoftë edhe nëse i hedhin poshtë kështu të gjitha fjalët e tjera të selefët!

¹³ Transmetojnë Buhariu (2652) dhe Muslimi (2533) nga Abdullah ibën Abasi, radijAllahu anhu.

¹⁴ Transmeton Ibën Ebu Asim në “Es Sunneh” (82) nga Ebi Malik el Esharij, radijAllahu anhu, dhe Albani e cilësoi si hadith Hasen në “Es Sahiha” (1331).

Pagabueshmëria u takon vetëm Pejgamberëve, salatet dhe selamet qofshin mbi ta, ndaj, fakti që disa marrin konkluzat e njërit apo dy personave dhe i braktisin ato të dijetarëve të tjerë konsiderohet lënie e *mubkemateve* dhe ndjekje e *muteshabihateve*.

Ndaj, kush argumenton me një thënie –në besim, metodologji apo trajtim- që kundërshton udhëzimin e Kuranit dhe Sunetit dhe të konsensusit të selefrit të umetit dhe pastaj nxjerr vendim për ndonjërin nga vëllezërit e vet në bazë të asaj fjale, atëherë fjala e tij është e refuzuar dhe e papranueshme, bile konsiderohet pasim i të dyshimtave, kurse Allahu i Lartësuar ka thënë: **“E ata që në zemrat e tyre kanë anim kah e shtrembëta, ata gjurmojnë atë që nuk është krejt e qartë për të shkaktuar hutim dhe që t’i komentojnë sipas dëshirës së tyre”**. (Alu Imran: 7)

Ky ajet përfshin çdo *muteshabih* nga citatat (e Kuranit dhe Sunetit) apo fjalët e selefrit dhe është transmetuar në hadith autentik se Pejgamberi, alejhi selam, ka thënë: “Nëse i shihni ata që ndjekin gjërat e paqarta, të tillët janë ata që i ka përmendur Allahu, ndaj kujdes nga ata!”¹⁵

¹⁵ Transmetojnë Buhariu (4547) dhe Muslimi (2665) –fjala e tij nga Aishja, radijAllahu anhu.

2) Përcjellja e gabimeve të dijetarëve mes teprimit dhe neglizhencës

Me teprim kemi për qëllim teprimin në pasimin e gabimeve të dijetarëve si dhe kriticizmin në disa fjalë ose për shkak të fanatizmit ose për shkak të rregullit: kundërshto e njihu, ose për shkak të famës apo edhe shkaqe të tjera.

Me neglizhencë kemi për qëllim refuzimin e dijetarit apo përpjekjen për ta ulur poshtë dhe paralajmërimin prej tij për shkak të atij gabimi.

Të dyja ekstremet janë të qortuara.

Kërkuesit e dijes e kanë obligim që të ndjekin rrugën e *selefus salih* në këtë çështje, sikurse në çështjet e tjera, duke respektuar dijetarët, duke i ngritur ata, duke i nderuar dhe duke ua ruajtur nderin e duke u dhënë pozitën që meritojnë, edhe nëse mund të bëjnë ndonjë gabim.

Në anën e kundërt, ata i refuzojnë gabimet me argumente shariatike të besueshme, pa lajka, por me butësi dhe urtësi, larg sharjes e ofendimit, që është bërë zakon te disa, të cilët gëzohen me gabimin e dijetarit ose kërkuesit të dijes, që ta rrëzojnë apo t'ia prishin imazhin e atij apo t'ia ulin vlerat. Ndodh që dijetari e jep konkluzën e vet pas një studimi në një çështje dhe gabon apo nuk ia ka qëlluar dhe e ka kundërshtuar argumentin, por ai në këtë rast nuk përndiqet për këtë gabim e as nuk paralajmërohet prej tij për të.

Dijetari i madh Ibën Kajimi, rahimehullah, ka thënë: “Dallimi mes pasimit të çiltër të të pagabueshmit dhe mes hedhjes poshtë të fjalëve të dijetarëve dhe anulimit të tyre është se pasimi i çiltër do të thotë që para tij nuk vjen as fjala e as mendimi i askujt, kushdo qoftë ai. Bile, së pari shikon saktësinë e hadithit, e nëse është i saktë, atëherë shikon përmbajtjen dhe kur të bëhet i qartë, nuk largohesh prej tij edhe nëse të kundërshtojnë njerëzit që nga lindja e deri në perëndim. Allahu na ruajt që umeti të bjerë në pajtim me atë që kundërshton fenë e Pejgamberit të tij (umetit), edhe pse patjetër që do të jetë nga umeti dikush që thotë të kundërtën, dhe nëse ti nuk e di këtë, mos e shndërro këtë në argument të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, sal-lAllahu alejhi ve sellem, por ndiq citatin dhe mos u dobëso. Dije se dikush e ka thënë atë gjithsesi, mirëpo ty nuk të ka arritur kjo, duke mos e nënçmuar pozitën e dijetarëve dhe miqësimin e tyre, me bindje në ruajtjen e nderit të tyre dhe se ata janë besnikë dhe përpiqen maksimalisht për ruajtjen e fesë dhe rregullimin e saj, kështu që ata qëndrojnë mes një shpërblimi, dy shpërblimeve apo faljes. Mirëpo, kjo nuk nënkupton përbuzjen e civateve dhe dhënien prioritet fjalës së dikujt para civateve për shkak të një dyshimi për të cilën ai është më i ditur sesa ti. Nëse është kështu, ai që ndjek citatin është më i ditur se ti me të dhe nëse je i singertë, duhet ta pranosh! Kështu që kush i lë fjalët e dijetarëve para civateve dhe i peshon me to si dhe kundërshton prej fjalëve të tyre ato që kundërshtojnë citatin, ai nuk i ka përbuzur fjalët e dijetarëve e as nuk ua ka humbur vlerën, por konsiderohet ndjekës i

tyre meqë edhe ata kanë urdhëruar ashtu. Pra, ndjekës i tyre i saktë është ai që i zbaton porositë e tyre e jo ai që i kundërshton ata! Që do të thotë se kundërshtimi i tyre në fjalën që bie ndesh me citatin është më i lehtë sesa kundërshtimi i tyre në rregullat e përgjithshme në të cilat ata (dijetarët) kanë urdhëruar dhe ftuar, si dhënia përparësi citatit para fjalës së tyre. Nga këtu bëhet i qartë dallimi mes imitimit të dijetarit në të gjitha fjalët e tij dhe mes të ndihmuarit me kuptimin e tij dhe ndriçimit me dritën e dijes së tij; i pari (imituesi) e merr fjalën e tij pa e medituar fare, as nuk është kërkues i argumentit nga Kurani dhe Suneti, por dijetarin e bën si një litar që e lidh në qafen e vet dhe i ecën nga pas me të, ndaj edhe quhet pasues i verbër, përkundër atij që ndihmohet me kuptimin e dijetarit dhe ndriçohet me dritën e dijes së tij për të arritur tek i Dërguari, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Ky i konsideron këta në pozitën e udhëzuesit për të arritur tek udhëzuesi i parë dhe kur arrin aty, nuk ka më nevojë për argumentimin e tij, sikurse ai që udhëzohet me yllin për ta gjetur kiblën, që nëse e gjen, nuk ka më kuptim udhëzimi i yllit! Shafiu, rahimehullah, thotë: “Njerëzit janë unanimesë se atij që i bëhet i qartë Suneti i të Dërguarit të Allahut, nuk i lejohet ta lërë atë për fjalën e askujt¹⁶”.

Allahu të ruajt, shikoje raportin e dijetarëve të ehlu sunetit me Neveviun, Ibni Haxherin ose me Ibën Huzejmen, të cilin dijetarët e kishin etiketuar si imami i imamëve- nga të cilët

¹⁶ “Er Ruhū”, fq. 264.

kishin rrjedhur gabime dhe interpretime, qoftë edhe në çështje të besimit, mirëpo ata kishin kontribute në dije dhe në shërbim të Sunetit për të cilat shpresojmë se ua mbulojnë lëshimet e gabimet, ku në disa prej tyre ata janë veç transmetues (e jo thënës të tyre).

Dijetarët ende përfitojnë nga librat e tyre dhe marrin nga dija e tyre si dhe i nxisin kërkuesit e dijes që të përfitojnë prej atyre librave duke tërhequr vërejtjen ndaj atyre gabimeve dhe duke e sqaruar të vërtetën me argument, duke i arsyetuar dijetarët dhe duke mos i ndjekur ato lëshime. Për këtë shiko vërejtjet e shejh Abdulaziz ibën Bazit, rahimehullah, në fillim të “Fet’hul Bari”.

Si ilustrim të kësaj kemi atë që ka cituar Ibën Tejmije, rahimehullah, nga Ebu Musa el Medini, i cili ka thënë: “E kam dëgjuar prijësin e Sunetit, El Asbahanin, duke thënë: “Muhamed ibën Huzejme gabo i në hadithin e sures (fizionomisë), ama ai nuk akuzohet për këtë, porse vetëm nuk i merret kjo”. Ebu Musa ka thënë: “Me këtë fjalë ka për qëllim se s’ka imam që nuk ka gabime dhe sikur ai imam të braktisej për atë gabim të tij, do të braktiseshin shumë imamë të tjerë! Dhe kjo nuk duhet të ndodhë¹⁷”.

Ndërsa shejh Uthejmini, rahimehullah, thotë: “Rinia e kanë për obligim të durojnë për atë që ndodh mes dijetarëve nga kundërshtimet me njet të mirë dhe përpjekje për të ardhur tek e vërteta si dhe t’i arsyetojnë ata në gjërat që kanë gabuar.

¹⁷ “Bejanu telbisul xhehmije” (410-411).

Nuk ka të keqe nëse flasim me ta për gjërat që mendohet se kanë gabuar, që t'ua bëjnë të qartë se a është gabimi nga ata apo prej atyre që kanë pretenduar gabimin e dijetarëve, ngase njeriu ndonjëherë mendon se fjala e një dijetarit është gabim, mirëpo pas debatit i bëhet e qartë e qëlluara dhe njeriu është njeri, gabon. Pejgamberi, alejhi selam, ka thënë: “Çdo bir i Ademit është gabimtar, por më i mirë i gabimtarëve është ai që pendohet¹⁸”. Por që të gëzohet me lëshimin e dijetarit dhe gabimin e tij, që ta përhapë atë në mesin e njerëzve dhe të ndodhin përçarje, kjo nuk është nga metoda e selefit¹⁹”.

Ai, rahimehullah, po ashtu ka thënë: “Qëndrimi i kërkuesit të dijes nga lëshimet dhe gabimet e dijetarëve duhet të destinohet në dy drejtime:

a) përmirësimi i gabimit, që është obligativ, ku çdokush që has në një lëshim të dikujt –qoftë edhe nga dijetarët më të mëdhenj- duhet të tërheqë vërejtjen për atë lëshim e gabim sepse sqarimi i së vërtetës është gjë e domosdoshme, ndërsa me heshtje mund të tretet e vërteta për shkak të respektit ndaj atij që e ka thënë të kotën, gjersa respektimi i së vërtetës është më prioritar për kujdes;

b) me përmirësim të ketë për qëllim shfaqjen e mangësive të tij e jo sqarimin e së vërtetës. Kjo vjen nga njeriu ziliqar, Allahu na ruajt, duke shpresuar të gjejë fjalë të dobëta apo

¹⁸ Transmetojnë Hakimi në Mustedrekun e tij (7617), Tirmidhiu në Sunenin e tij (2499), Ibën Maxheh (4251) dhe të tjerët nga Enes ibën Maliku, radijAllahu anhu, dhe Albani e vlerësoi si Hasen në “Sahihul Xhamië” (4515).

¹⁹ “Mexhmu’ul fetava” (26/91).

gabime te një person i caktuar dhe ta përhapë atë në mesin e njerëzve.

E rëndësishme është që qëllimi yt nga sqarimi të jetë shfaqja e së vërtetës dhe kush e ka këtë qëllim, i jepet sukcesi në pranimin e tij, ndërsa kush ka për qëllim përhapjen e turpeve të njerëzve, atëherë *“kush ndjek të metat e vëllait të vet, Allahu ia përcjell atij turpet, e kujt ia përcjell Allahu turpet, ia zbulon të metat e tij, qoftë edhe ato që i bën në brendinë e shtëpisë së tij”*. Kështu që nëse has në ndonjë gabim të një dijetari, përpiqu ta largosh qortimin ndaj tij dhe ta mbrosh atë, posaçërisht nëse është nga dijetarët e dëshmuar me drejtësi, mirësi dhe këshillim të umetit²⁰.

Kjo fjalë e tij ka shtojcë akoma dhe është nga margaritarët e këtij alimi të madh. Le të ketë frikë Allahun kushdo që është tunduar nga prekja e nderit të dijetarëve dhe mbjellja e trazirave në mes të dijetarëve dhe kërkuesve të dijes dhe nga shfrytëzimi i disa lëshimeve dhe gabimeve ose të asaj që hamendësohet si gabim.

O kërkues i dijes, bëhu çelës i hairit dhe mbyllës i sherrit, mos u bëj çelës i sherrit dhe mbyllës i hairit, i përlyer me nderet e dijetarëve dhe kërkuesve të dijes, ngacmues i tyre me prishje të imazhit ose teprim, ose kushtëzim me çka nuk duhet kushtëzuar, ose këputës i fjalëve të tyre...

²⁰ “Mexhmuul fetava” (26/219), kurse hadithin e transmetuan Ibën Hibani në Sahihun e tij (5763), Tirmidhiu në Sunenin e tij (2032) dhe të tjerët nga Ibni Umeri, radijAllahu anhu, dhe e saktësoi Albani në “Sahihut Tergib” (2339).

Enes ibën Maliku, radijAllahu anhu, transmeton se i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Vërtet që nga njerëzit ka të atillë që janë çelësa të hairit dhe mbyllës të sherrit, kurse ka të atillë që janë çelësa të sherrit dhe mbyllës të hairit. I lumtë atij që Allahu çelësat e hairit i ka lënë në dorën e tij, por mjerë ai që çelësat e sherrit i ka lënë në dorën e tij!”²¹

Dhehebiu, rahimehullah, në biografinë e mufesirit të madh Katade ibën Diameh es Sedusi, rahimehullah, pasi e ka arsyetuar për gabimet e tij, ka thënë: “Nëse një imam i madh i dijes të qëlluarat i ka të shumta dhe njihet si hulumtues i së vërtetës dhe dija e tij është e gjerë, është i mençur dhe njihet për devotshmërinë, modestinë dhe pasimin e tij, atij i falen gabimet e nuk e konsiderojmë të devijuar, as nuk e hedhim poshtë dhe as nuk i harrojmë veprat e tij të mira. Po, nuk e pasojmë atë në risinë e gabimin e tij, por i urojmë pendim nga ajo²²”.

Kurse në mbrojtje të imam Muhamed ibën Nasër el Merveziut, rahimehullah, ai tha: “Sikur ne sa herë që gabon ndonjë imam në ixhtihadin e tij në çështje të caktuara me gabime të falura, të ngrihem i me qortim kundër tij dhe ta shpallim si risimtar e ta bojkotojmë, nuk do të kishte shpëtuar nga ne as Ibën Nasri e as Ibën Mendeh apo dikush tjetër më i madh se këta të dy. Por, Allahu është udhëzuesi i

²¹ Transmetojnë Ibën Maxheh në Sunenin e tij (237), Bejhakiu në “Shuabul iman” (687) dhe Ibën Mubareku në “Zuhd” (968) dhe Albani e vlerësoi si hasen në “Es Sahiha” (1332).

²² “Es Sijer”, 5/271.

krijësive kah e vërteta, Ai është më i mëshirshmi Mëshirues, kurse ne kërkojmë mbrojtje nga Allahu prej tekave dhe vrazhdësisë²³”.

Në biografinë e imamit të imamëve Ibën Huzejmes, rahimehullah, ai ka thënë: “Libri i tij në tevhid është një vëllim i madh dhe në të ka keqinterpretuar hadithin e *sures* (fizionomisë), por duhen arsyetuar disa që keqinterpretojnë disa nga cilësitë e Allahut, ndërsa selefi nuk u zhytën në interpretime, por besuan dhe u ndalën, ndërsa dijen rreth cilësive ia lanë Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Dhe sikur çdokënd që gabon në konkludimin e tij –duke pasur besimin e drejtë dhe kujdesin e tij për ta ndjekur të vërtetën- ta kishim hedhur poshtë dhe ta kishim shpallur risimtar, atëherë pakkush nga imamët do të kishte shpëtuar nga ne (kritikat tona). Allahu i mëshiroftë të gjithë me mirësinë dhe bujarinë e Tij!”²⁴

3) Shtirja me dije, marrja për “myfti” e të vegjëlve dhe të mashtruarit me veten, shenjtërimi i personave

Shtirja me dije është sëmundje e zemrës që i kap disa me besim të dobët, e cila i shtyn të flasin nxitimthi për gjëra që nuk i njohin, flasin për atë që nuk kanë përvojë, thonë për Allahun gjëra pa dije dhe “veshin” rrobat e dijetarëve të

²³ “Es Sijer” (14/40).

²⁴ “Es Sijer” (14/376).

zgjedhur, kur në realitet janë shumë larg metodologjisë së tyre të pastër.

Ata e vënë veten në pozitën e nxjerrjes së fetvave (myftiut) në çështje madhore për të cilat dikur tuboheshin të mëdhenjtë e muhaxhirëve dhe ensarëve, derisa pyetësi pyeste njëqind e njëzet sahabë, por të gjithë abstenonin nga dhënia e fetvasë²⁵, jo për shkak të fshehjes së dijes, por nga frika prej Allahut: **“Por Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët”** (Fatir: 28) dhe nga frika e gabimeve, ndaj nuk flisnin vetëm aty ku ishin ekspertë, ku argumentet ishin sikurse dielli në mes të ditës. Allahu i Lartmadhëruar thotë: **“Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të parit dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi”** (Isra: 36). Dhe: **“Thuaj: Zoti im ndaloi vetëm imoralitetin, le të jenë të hapta ose të fshehta, ndaloi mëkatin, ndaloi shtypjen e tjetrit pa të drejtë, ndaloi t’i vishni Allahut shok pa pasur për të kurrfarë argumenti dhe ndaloi të thoni për Allahun atë që nuk e dini se është e vërtetë”**. (Araf: 33).

Medito, Allahu të ruajt, për qëndrimin e Ebu Bekrit, radijAllahu anhu, kur u pyet për fjalën e Allahut: **“dhe pemë e kullosa”** (Abese: 31) e tha: *“Cili qiell më strehon dhe cila tokë*

²⁵ El hafidh Ibën Abdulberri e ka transmetuar në “Xhamiu bejanil ilmi” (2201) nga Abdurrahman ibën Ebi Lejla, i cili thotë: “I kam takuar njëqind e njëzet nga Ensarët nga shokët e Muhamedit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, dhe secili prej tyre kur pyetej për diçka, veçse shpresonte që shoku i tij të përgjigjej dhe nuk transmetonte ndonjë hadith, veçse shpresonte që shoku i tij të fliste me të”.

*më mban nëse them për librin e Allahut atë që nuk e di*²⁶, derisa e mësuan komentin e saj përmes gjuhës së arabëve. I njëjtë ishte qëndrimi i tij, radijAllahu anhu, për t'ia dhënë një të gjashtën e trashëgimisë gjyshes²⁷ dhe qëndrime të tjera që aludojnë për modestinë dhe frikën e tyre nga Allahu. Si ai ishin edhe sahabët e tjerë dhe tabiinët.

Nga shkaqet e shtirjes me dije është dashuria për shfaqje, syfaqësia dhe injoranca për fenë e vërtetë të Allahut dhe prezenca e hipokritëve protagonistë të selefizmit në mesin e selefive, e disa mashtrohen pas atyre hipokritëve duke ua shtuar edhe padijen, si dhe qëndrimi larg i tyre nga dijetarët edukatorë, saqë për një të shtirur është thënë se dëshmia e tij vlen sa dëshmia e njëqind burrave!!

Prandaj, kërkojmë mbrojtje nga Allahu prej trazirave të dukshme dhe të fshehta dhe kërkojmë mbrojtje nga Allahu prej devijimit pas udhëzimit!

Dijetari Bekër Ebu Zejd, rahimehullah, ka thënë: “Sa të rëndomtë i kemi parë në hallkat e dijes, mësymës të shfaqjes para se të piqen, të nominuar para se të ngrihen, që e pretenduan (dijen) para se të jenë gati... e veçse është thënë se fillimi është tokë e gabimeve”. Po ashtu ka thënë: “Prej belasë është kur mashtruesit bëhen dijetarë! Transmetohet

²⁶ Transmetojnë Ibën Ebi Shejbeh në Musnedin e tij (30107) dhe Bageviu në “Sherhun Sunneh” (1/264).

²⁷ Transmetojnë Tirmidhiu në Sunenin e tij (2100, 2101), Ibni Hibani në Sahihun e tij (6031), Hakimi në Mustedrekun e tij (7978) dhe e saktësoi dhe e aprovoi Dhehebiu, kurse Ibni Haxheri, rahimehullah, në “Telhisul habir” (3/179) tha: “Zinxhiri i tij është autentik, porse mursel?”.

nga imam Ali ibën Ebi Talibi, radijAllahu anhu, se ka thënë:
“Dija është një pikë, e kanë shumëuar injorantët!”²⁸

Shejh Bekër Ebu Zejdi, rahimehullah, më pas ka sjellë edhe fjalë të tjera të mrekullueshme të disa dijetarëve në këtë fushë, si më poshtë:

Ibën Abdulberri, rahimehullah, ka thënë: “Sikur të heshtte ai që nuk di, do të humbnin kundërshtimet²⁹”.

Imam Shafi'u, rahimehullah, ka thënë: “Ata që dinë, duhet ta flasin vetëm atë që dinë sepse në dije ka folur dikush, i cili sikur të heshtte për disa gjëra që ka folur, heshtja do të ishte më prioritare dhe më shpëtimtare për të, inshaAllah³⁰”.

Ibën Haxheri, rahimehullah, ka thënë: “Kur njeriu flet në profesionin e huaj, vjen me çudira³¹”.

Sufjan Thevriut, rahimehullah, i janë përmendur muhadithët e shumtë dhe ka thënë: “A nuk përmendet një shembull: Kur shtohen lundruesit, fundoset anija?”³²

Ibën Hazmi, rahimehullah, ka thënë: “Nuk ka gjë më të dëmshme për dituritë dhe njerëzit e dijes sesa ndërhyrësit në to, që nuk janë prej tyre, të cilët janë të padijshëm, por

²⁸ “Et Tealumu”, fq. 7, kurse fjalën e Aliut, radijAllahu anhu, e ka shënuar Murteda ez Zubejdi në “Taxhul arus” (20/153) dhe Sanani në “Subulis Selam” (2/651).

²⁹ “Xhamiu bejanil ilmi” (999).

³⁰ “Er Risale” (34).

³¹ “Fe’hul bari” (3/584).

³² “El Muhaddith el Fasil” (1/560) i Ramhermeziut.

hamendësojnë se dinë dhe prishin ndërkohë që llogarisin se po ndreqin³³”.

Medito, Allahu të begatofte, për hadithin e shtirësit me atë që nuk i është dhënë dhe kërcënimin që është theksuar për të. Nga Esmaja, radijAllahu anha, transmetohet se një grua tha: -O i Dërguar i Allahut, unë kam një ortake, a kam mëkat nëse shtirem para ortakes sime se burri më jep gjëra që në realitet nuk m'i jep³⁴” I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, tha: *“Kush shtiret me atë që nuk i është dhënë, është sikur ai që vesh rrobat e mashtrimit³⁵”*.

Ekzistojnë edhe shkaqe të tjera përveç këtyre që u përmendën, më të mëdhatë janë rënia në mëkate, ndjekja e tekave dhe kundërshtimi i civateve që urdhërojnë për këshillim të çdo muslimani.

³³ “El Ahlaku ves Sijer” (23).

³⁴ Me qëllimi provokimi dhe zemërimi të saj.

³⁵ Transmetojnë Buhariu (5219) dhe Muslimi (2130).

Frugët e shërimit të kësaj dukurie

Shërimi i problemit të shkëputjeve, ndarjes, grindjes, bojkotit dhe rruga drejt largimit të çarjes mes ndjekësve të një metodologjie është punë e lehtë duke falënderuar Allahun – qoftë i lavdëruar dhe i lartësuar- atëherë kur ne jemi të sigurtë vetëm për të vërtetën dhe dëliremi nga tekat e nefsit dhe nijetet tona janë të çiltërta vetëm për Allahun. Këtu do përmend disa mjete shëruese me ilustrime, jo të kufizuara:

1) Mbatja e lidhjeve mes besimtarëve në përgjithësi dhe mes kërkuesve të dijes në veçanti, meqë puna më madhështore përmes së cilës shërohet kjo dukuri është kontakti dhe mëshira e ndërsjellë dhe bashkëpunimi mes ehlu sunetit, selefive, ndjekësve të së njëjtës rrugë. Edhe mësuesi ynë, shejh Abdulmuhsin el Bedër, Allahu e ruajt, shkroi një risale (libërth) të titulluar “Silluni butë mes vete o ndjekës të Sunetit”, e pas një kohe shkroi një risale tjetër “Edhe një herë, silluni butë mes vete o ndjekës të Sunetit”. Po ashtu edhe mësuesi ynë, shejh Abdulaziz bin Bazi, Allahu e mëshiroftë, kishte shkruar një risale të bukur për të udhëzuar thirrësit selefij, të zotët e besimit të drejtë, shtegtuesit në metodën e selefus salih.

Andaj, duke u nisur nga udhëzimi i Kuranit dhe Sunetit dhe nga ajo që kam përfituar prej këshillave të mësuesve tanë të ndershëm dhe duke pasur për qëllim këshillën për Allahun, për Librin e Tij dhe për të Dërguarin e Tij dhe për imamët e muslimanëve në përgjithësi, si dhe nga mëshira ndaj

kërkuesve të dijës dhe thirrësve nga ky copëzim dhe ndasi dhe largim i çarjes e tretje e mundësisë për ata që gjuajnë në ujë të turbullt, unë propozoj që disa dijetarë dhe kërkues dije ta shikojnë sërish rrugën e shërimit për gabimet që ndodhin nga disa. Kjo ndodh duke kontaktuar mes vete dhe duke ndjekur udhën e dijetarëve e mësuesve tanë –të hershëm apo të tashëm- me përpjekje të madhe, duke filluar me këshilla para refuzimit. E nëse ka nevojë për refuzim, atëherë përmes butësisë dhe urtësisë, kurse neve na takon që të lexojmë me përsiatje të madhe librin e Ibën Rexhebit, rahimehullah: “Dallimi mes këshillës dhe turpërimit”, pasi ky libër ka përfshirë çështje të rëndësishme që kërkuesi i dijës duhet t’i ketë në konsideratë kur t’i këshillojë vëllezërit e vet.

Dy dijetarët e mëdhenj të ndershëm Muhamed Nasirudin Albani dhe shejh Hamud et Tuvejxhiri, Allahu i mëshiroftë, kanë treguar shëmbëlltyrën më të shkëlqyer në tolerancë dhe nderim të dijetarëve në refuzimet e fuqishme që ia bënë njëri-tjetrit në mesele të ndryshme, pasi (përkundër refuzimeve reciproke të tyre) kur takoheshin dhe u shtrohej ndonjë pyetje (nga të tjerët), ata ia kalonin pyetjet njëri-tjetrit (urdhëro ti përgjigju, jo urdhëro ti përgjigju), duke e shprehur vëllazërinë dhe dashurinë e sinqertë që i bashkonte. Kjo shëmbëlltyrë përsëritet edhe mes shejh Bin Bazit dhe shejh Albanit, Allahu i mëshiroftë, në çështjet e dijës ku nuk pajtoheshin. E të tillët **“ishin që Allahu i udhëzoi në rrugë të drejtë, andaj edhe ti merri shembull në udhëzimin (rrugën) e tyre”** (Enam: 90).

Ndiqini këta, pasoni rrugën e tyre, mëshironi njëri-tjetrin dhe përpiquuni për rregullimin e marrëdhënieve midis jush dhe largimin e çarjes brenda suazave të metodologjisë së *selefus salih*.

2) Kthimi i mosmarrëveshjeve të Libri i Allahut dhe Suneti i të Dërguarit të Tij, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

Këtë e sqaruam më lart.

3) Mbështetja të metodologjia e *selefu salih* në thirrjen tek Allahu i Lartësuar, duke studiuar jetëshkrimin dhe metodat e tyre në thirrje dhe se si ata e respektonin njëri-tjetrin. Nuk kemi dëgjuar se ata përpiqeshin ta mundnin njëri-tjetrin për ego, apo se tentonin ta hidhnin poshtë vëllain e vet, apo ta deformonin fjalën e vëllait që ta hiqnin qafe atë, ose që të paralajmëronin nga ai kur gabonte para se ta këshillonin ose drejtonin, ose të shpifnin për të thjesht sepse nuk pajtoheshin me të në një këndvështrim apo mesele ixhtihadije që pranon këndvështrimet e ndryshme, ashtu sikurse nxorën ixhtihade ata që ishin para nesh.

Kjo është rruga e besimtarëve besnikë, e thirrësve të sinqertë, të cilët ftojnë tek Allahu me dituri. Ecja në udhëzimin e tyre është rruga e vetme për të bashkuar fjalën dhe unifikuar radhët si dhe lumturia në të dyja botët.

4) Kthimi te dijetarët edukatorë, të cilët gjykojnë me të vërtetën dhe me të mbajnë drejtësi.

Pa dyshim që dijetarët janë shenjat e udhëzimit dhe pishtarët e rrugëtimit, ndaj kush i shmanget rrugës së tyre dhe nuk kthehet tek ata gjatë ndodhive, ai ka për të devijuar vetë dhe ka për t'i devijuar të tjerët. Allahu, qoftë i lavdëruar dhe i lartësuar, thotë: **“E sikur t’ia linin atë Pejgamberit dhe përgjegjësve të tyre, ata do të dinin të nxirrnin përfundime”**. (Nisa: 83).

Dhe: **“...andaj pyetni dijetarët, nëse ju nuk dini”**. (Nahl: 43)

5) Modestia.

*“Kush tregohet modest për Allahun, Allahu e ngre atë”*³⁶, ndërsa kryelartësia ndaj njerëzve dhe të shtirurit me dije sjellin mendjemadhësi. Kur thirrësi ose kërkuesi i dijes tregohet mendjemadh, ai devijon dhe i lajthit të tjerët, bile kjo e prish sinqeritetin dhe për këtë shkak transmetohet nga Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, se i pari që gjykohet në Ditën e Kiametit është “personi që ka mësuar dije dhe i ka mësuar të tjerët dhe ka lexuar Kuran. Kur sillet (para Allahut) dhe i dëftohen mirësitë e Tij dhe ai i pranon, i thuhet: -Çka ke bërë me to? Ai thotë: -E kam mësuar dijen

³⁶ Transmeton Taberaniu në “El Muaxhemul Evsat” (8307) nga Umeri, radijAllahu anhu, dhe Ebu Nuajmi në “El Hilje” (8/46) nga Ebu Hurejra, radijAllahu anhu dhe të tjerët, kurse Albani e saktësoi në “Es Silsile” (2328).

dhe ua kam mësuar të tjerëve dhe e kam lexuar Kuranin për Ty. I thuhet: -Po gënjen, por ke mësuar dije që të të thuhet dijetar dhe ke lexuar Kuran që të thuhet lexues dhe ashtu të është thënë. Pastaj urdhërohet që të zvarritet me fytyrë dhe hidhet në zjarr³⁷”.

6) Mbjellja e rrënjëve të vëllazërisë dhe dashurisë mes dijetarëve dhe kërkuesve të dijes, duke u nisur nga parimi i dashurisë e urrejtjes për Allahun, miqësismit e armiqësisë për Allahun dhe nga dëshira për humanizëm. Kështu që lidhja e besimit mes besimtarëve është ndër lidhjet më të fuqishme. Allahu i Lartësuar thotë: **“Besimtarët dhe besimtare janë miq për njëri-tjetrin”** (Tevbe: 71) dhe: **“Në të vërtetë, besimtarët janë vëllezër”** (Huxhurat: 10). Kurse i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: *“Muslimani është vëlla i muslimanit, as nuk i bën padrejtësi, as nuk e zhgënjën e as nuk e nënçmon³⁸”*. Dhe: *“Besimtari për besimtarin është si një pasqyrë, besimtari është vëlla i besimtarit, i mjafton atij për nevojat e tij dhe e ruan nga mbrapa³⁹”*.

Besimtari gjithashtu është ai që ndien dhembje për dhembjet e vëllezërve të vet dhe shpreson atë që shpresojnë ata, e lë

³⁷ Transmeton Muslimi në Sahihun e tij (1905) nga Ebu Hurejra, radijAllahu anhu.

³⁸ Transmeton Muslimi në saihun e tij (2564) nga Ebu Hurejra, radijAllahu anhu.

³⁹ Transmetojnë Buhariu në “Edebul mufred” (239), Ebu Davudi në Sunenin e tij (4918), Bejhakui në “Adab” (90) dhe të tjerët nga Ebu Hurejra, radijAllahu anhu, dhe e saktësoi Albani në “Es Sahiha” (926).

veten keq për ta për ndonjë nevojë, edhe pse ai vetë është nevojtar. Medito me mua edhe këtë ndodhi në betejën e Jermukut:

Hudhejfe El Adevij, rahimehullah, rrëfen: “Në ditën e Jermukut dola që ta kërkoja djalin e xhaxhait tim dhe kisha me vete pak ujë dhe thosha me vete: -Nëse ka etje, do t’i jap të pijë. Kur ja, e gjeta dhe i thashë: -A të të jap të pish? Me kokën e tij më tha që po. Kur papritmas një burrë rënkonte ah ah. Djali i xhaxhait tim ma bëri me shenjë që shko tek ai. Ai ishte Hisham ibnul Asi. I thashë: -A të të jap të pish? Ma bëri me shenjë që po. Kur dëgjoi dikë tjetër duke rënkuar ah ah, ma bëri Hishami me shenjë që të shkoja te tjetri. Kur shkova te tjetri, ai kishte vdekur. U ktheva tek Hishami, edhe ai kishte vdekur. Pastaj u ktheva te djali i xhaxhait tim, kur ja edhe ai kishte vdekur⁴⁰”.

Kjo është e ndërtuar mbi fjalën e të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: “*Shembulli i besimtarëve në dashurinë, mëshirën dhe dhembshurinë mes tyre është sikur të jenë një trup, nëse një gjymtyrë e tij ankohet, i tëri trupi mbetet pa gjumë dhe me ethe*⁴¹”.

Dhe mbi fjalën e tij: “*Besimtari për besimtarin është si një ndërtesë, e cila e shtrëngon njëra pjesë tjetrën*”⁴² dhe i bëri gishtat e tij si rrjetë.

⁴⁰ “Tefsiri i Kurtubiut” (18/28), botimi i Darul kutub el Ilmije.

⁴¹ Transmeton Muslimi (2586) nga Nu’man ibën Beshir, radijAllahu anhu.

⁴² Transmeton Buhariu (481) dhe Muslimi (2585) nga Ebu Musa el Esharij, radijAllahu anhu.

Prandaj, për Allahun, o thirrës të Sunetit zbatoni këtë parim mes jush dhe vëllezërve tuaj sepse është ilaçi më i mirë për ta larguar urrejtjen dhe për t'i bashkuar fjalët e për t'i unifikuar përpjekjet në thirrjen tek Allahu i Lartësuar. Hoxha i Islamit, Ibën Tejmije, rahimehullah, thotë: “Allahu i ka bërë robërit e Tij besimtarë miq të njëri-tjetrit, i ka bërë vëllezër, që e ndihmojnë njëri-tjetrin, mëshirohen mes vete dhe janë në harmoni. Ai, qoftë i lartësuar, i ka urdhëruar që të bashkohen dhe i ka ndaluar nga përçarja dhe divergjencat. Ai thotë: **“Dhe kapuni që të gjithë ju për litarin e Allahut e mos u përçani”** (Alu Imran: 103). Dhe thotë: **“Vërtet ata që e përçanë fenë e tyre dhe u ndanë në grupe, ti (Muhamed) nuk ke kurrfarë përgjegjësie. Çështja e tyre është vetëm tek Allahu...”** (El En'am: 159)

Përkundër këtyre porosive si i lejohet umetit të Muhamedit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, të përçahet dhe të kundërshtohet, aq sa njeriu ta miqësojë një grup dhe ta urrejë një grup tjetër me paragjykime dhe teka, pa asnjë argument nga Allahu i Lartësuar?”⁴³

Po ashtu në mesazhin që Ibën Tejmija u dërgoi banorëve të Bahrejnit, kur këta bojkotuan njëri-tjetrin dhe u lëçitën dhe gati sa nuk u vranë për shkak të meselesë se a e shohin jobesimtarët Allahun e Lartmadhëruar në ahiret, ai përmendi fjalët e dijetarëve në këtë çështje e më pas përmendi pesë normat që duhen zbatuar:

⁴³ “Mexhmu’ul fetava” (3/419-420).

a) Kush hesht në këtë çështje dhe nuk propagandon asgjë, nuk lejohet të bojkotohet, edhe pse në vetvete ka mundësi të ketë një mendim (nga mendimet kundërthënëse), ngase edhe në risi më të mëdha se kjo nuk bojkotohet personi që hesht, përveç propaganduesit, në çështjen tonë kjo është edhe më prioritare.

b) Njerëzit e dijes nuk lejohet që këtë çështje ta shndërrojnë në provokim dhe shenjë për të bërë dallime mes vëllezërve dhe kundërshtarëve të tyre, ngase kjo është prej punëve që i urrejnë Allahu dhe i Dërguari i Tij, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem.

c) Me këtë çështje nuk e hapin muhabetin me muslimanët e rëndomtë të cilët janë larg dhe në rehati nga fitnet (trazirat), mirëpo nëse njeriu pyetet për to apo e sheh se dikush e meriton të njihet me atë çështje, atëherë i shpjegon atij nga dija që posedon nëse shpreson të jetë e dobishme.

d) Nëse çështja mjegullohet, se a thua vallë kjo fjalë apo vepër e imponon apo jo dënimin për thënësin apo vepruesin e saj, atëherë lënia e dënimit është obligative për shkak të fjalës së Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: “*Shmangni ndëshkimet kur ka dyshime sepse të gabosh në falje është më e mirë sesa të gabosh në ndëshkim*”. Transmeton Ebu Davudi⁴⁴.

⁴⁴ Njësoj e transmetoi edhe Hakimi në Mustedrekun e tij (8136) dhe tha hadithi është me sened të saktë. E shënoi Bejhakiu në “Sunen el Kubra” (17062) dhe tha: “I këputur dhe nga sahabi vetëm/mevkuf”. E shënoi Bageviu në “Es Sunneh” (10/330) dhe tha: “Nuk është i ngritur deri te Pejgamberi, kurse Albani e vlerësoi të dobët në “Daif Sunenut Tirmidhi” (1424). Por saktësohet si fjalë e Abdullah ibën Mesudit, radijAllahu anhu, i cili tha: “Shmangeni

Posaçërisht nëse çështja anon kah një e keqe e madhe dhe çon në ndasi të ehkus sunetit dhe xhematit, atëherë dëmi që zhvillohet në këtë ndasi është shumëfish më i madh se prishja që zhvillohet nga një gabim i një grupi të vogël në një çështje degësore⁴⁵.

e) Nëse dikujt i mjegullohet çështja, atëherë le të lutet me atë që transmetohet nga Muslimi në Sahihun e tij nga Aishja, radijAllahu anha, e cila rrëfen se i Dërguari i Allahut kur ngrihej në namaz, thoshte: “O Allahu im, Zoti i Xhebrailit, Mikailit e Israfilit, shpikësi i qiejve dhe i tokës, Njohësi i së fshehtës dhe së dukshmes, Ti je Ai që gjykon mes robërve të Tu në kundërshtimet e tyre, na udhëzo me lejen Tënde kah e vërteta në ato që janë kundërshtuar, vërtet Ti udhëzon atë që do Ti në rrugë të drejtë⁴⁶!”

Kush vështron në urtësitë e sheriatit, e kupton se shumica e dispozitave ia japin ndjenjën besimtarit për rëndësinë e tubimit dhe bashkimit dhe qëndrimin larg nga përçarja e divergjencat dhe për këtë arsye sheriatit ka ndaluar nga

fshikullimin dhe vrasjen nga robërit sa më shumë të jetë e mundur”, të cilin e shënoi Taberaniu në “Muaxhemul kebir” (8947) dhe Bejhakiu në “Sunen el Kubra” (17064) dhe në “Mearifetus sunen” (16876), të cilin e saktësoi Albani në “Irvaul Galil” (8/26). Si dhe transmetohet nga Umer ibën Hatabi, radijAllahu anhu, në Musanefin e Ibën Ebi Shejbeh (28493) se ka thënë: “T’i pezulloj ndëshkimet për shkak të dyshimeve është më e dashur për mua sesa t’i zbatoj me dyshime”.

⁴⁵ Alimi i madh Muhamed ibën Ibrahim Alu Shejh, rahimehullah, thotë: “Bashkimi në të cilin ka mangësi të mëdha është më i mirë sesa përçarja për të cilën hamendësohet se ka hair të madh në të”. “El Fetava” (12/169).

⁴⁶ “Mexhmuul fetava” e Ibën Tejmijes (6/503-504), ndërsa hadithin e ka transmetuar Muslimi (770).

shumë lloje kontratash dhe marrëdhëniesh nga frika e rënies në mospajtime.

Pastaj, edhe pesë namazet, falja e tyre me xhemat, drejtimi i safave, agjërimi, haxhi dhe fakti që të gjitha këto janë në një kohë e bëjnë muslimanin e mençur e të dëlirë që të jetë i kujdesshëm në zhvillimin e kësaj dashurie dhe vëllazërie dhe bashkimit të fjalës si dhe mosdhënien e rastit armiqve të Islamit dhe Sunetit që të mos “peshkojnë” në ujë të cekët⁴⁷.

7) Obligueshmëria e bashkëpunimit në përhapjen e së mirës, edhe nëse ka mospajtime në disa mesele. Përçarja dhe kundërshtimi fraksionist i shpikur është ajo që qortohet, e cila i ka çuar të zotët e saj të ndahen nga xhemati dhe të miqësohen me njerëzit e risive.

Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Mos u bëni si ata që, pasi u erdhën provat e qarta, u përçanë dhe u grindën”** (Alu Imran: 105). Dhe tha: **“Me të vërtetë, ti s’ke të bësh fare me ata që e përçanë fenë dhe shndërrohen në sekte”** (Enam: 159), kurse i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, tha: “Dhe pa dyshim që umeti im do të përçahet në shtatëdhjetë e tre grupe, të gjitha do të jenë në zjarr, përveç njërit, që është xhemati⁴⁸”. Në një transmetim tjetër:

⁴⁷ Rreth këtij koncepti ktheju ligjëratës së shejh Rebi ibën Hadi me titull: “Nxitja në dashuri e bashkim dhe paralajmërimi nga përçarja dhe kundërshtimi”.

⁴⁸ Transmetojnë Ahmedi në Musnedin e tij (16973) nga Muavije ibën Ebi Sufjani, radijAllahu anhu, Ibën Maxhe në Sunenin e tij (3993) dhe Ibën Ebi

“Thamë: -Cili është ai, o i Dërguar i Allahut?” Ai tha: “(Kush ecën) Në atë që unë dhe shokët e mi jemi (nga feja) sot⁴⁹”.

Ibën Tejmije, rahimehullah, ka thënë: “Kjo përçarje që ka ndodhur nga umeti (dijetarë, hoxhallarë, prijës e njerëz të mëdhenj) është kjo që e ka sjellë sundimin e umetit nga armiqtë, ngase iu shmangën nënshtrimit ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, siç tha i Lartësuari: **“Ne morëm zotimin edhe të atyre që thanë: “Ne jemi të krishterë” e edhe ata e harruan një pjesë të asaj me të cilën ishin udhëzuar, andaj Ne kemi ndërsyer armiqësinë e urrejtjen ndërmjet tyre”** (Maide: 14). Kështu që sa herë që njerëzit harrojnë diçka nga urdhrat e Allahut, ka për të ndodhur ndërmjet tyre armiqësi dhe urrejtje, e kur përçahen njerëzit, ata prishen dhe shkatërrohen, ndërsa kur bashkohen, ndreqen dhe sundojnë, meqë xhemati është mëshirë, kurse përçarja është dënim”.⁵⁰

Ndërsa Ibën Kajimi, rahimehullah, ka thënë: “Procesi i ndarjes mes njerëzve patjetër se do të ndodhë për shkak të dallimit në qëllime, kuptime dhe kapacitetit të perceptimit, mirëpo ajo që qortohet është tejkalimi i kufijve karshi njëritjetrit duke bërë padrejtësi dhe duke kaluar në armiqësi. Në

Asimi në “Es Sunneh” (64) dhe të tjerët nga Enes ibën Maliku, radijAllahu anhu, dhe e saktësoi Albani në “Sahihul Xhami” (2042).

⁴⁹ Transmeton Taberaniu në “El Muaxhemul Evsat” dhe “Es Sagir” (4886) (724), El Axhurri në “Sheriah” (111) dhe të tjerët nga Enes ibën Maliku, radijAllahu anhu, dhe e saktësoi Albani në “Sahihut Tirmidhi” (2641).

⁵⁰ “Mexhmu’ul fetava” (3/421).

të kundërtën, divergjencat që nuk çojnë në ndarje dhe sektarizëm dhe kur të gjithë të mospajtuarit si synim kanë nënshtrimin ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, atëherë kjo divergjencë nuk sjell dëme, meqë është natyrë e pandashme e njeriut, por kur baza është e njëjtë dhe qëllimi është unik, si dhe rruga e ndjekur është një, është e pamundur të mos ndodhin mospajtimet, dhe edhe nëse ndodh, nuk sjell dëme, sikurse është përmendur nga divergjencat e sahabëve. Parimi mbi të cilin ata ndërtuan mendimet e tyre ishte një, ishte Libri i Allahut dhe Suneti i të Dërguarit të Tij, qëllimi ishte i njëjtë po ashtu: nënshtrimi ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij, edhe rruga po ashtu: vështtrimi në argumentet e Kuranit e Sunetit dhe dhënia përparësi këtyre para fjalës, mendimit, analogjisë, pëlqimeve e udhëheqjes së çdokujt tjetër⁵¹”.

Nga fjala e Ibën Tejmijes dhe nxënësit të tij Ibën Kajimit, rahimehullah, përfitojmë:

1- Kundërshtimet patjetër që do të ndodhin në umet, ashtu siç tha Pejgamberi, alejhi selam: “Kush do të jetojë nga ju pas meje, do të shohë kundërshtime të mëdha”.

2- Divergjenca e qortuar është divergjenca në bazamente dhe në atë që dijetarët e selefit janë të pajtimit prej meseleve të qëndrueshme që nuk pranojnë mospajtime. Ndërsa në

⁵¹ “Es Savaik el Mursele” (2/519).

mesaletë me ixhtihad, aty çështja është më e lehtë, elhamdulillah.

3- Kundërshtimi është dy llojesh: kundërshtimi në llojlojshmëri dhe kundërshtimi kontradiktor. I pari ndodh në çështjet ku janë transmetuar më shumë se një cilësi apo formë nga Ligjvënësi i Urtë, sikur forma e lutjes hapëse (të namazit), forma e teshehudit, format e ezanit dhe ikametit apo cilësitë e ndryshme të namazit të frikës e të tjera. Po ashtu kundërshtimi në çështje të fikhut, ku secili ka shprehur mendimin e vet sipas asaj që ia ka shfaqur argumenti optimal. Kundërshtimi kontradiktor ndodh te çështjet ku vetëm sipërfaqësisht duket se ka mospërputhje, atëherë duhet të kthehemi te rrugët e bashkimit dhe konkluzës që janë të njohura te selefi, kurse në lidhje me tekstet apo citatat e dukshme e të qarta (*mubkem*), e kemi obligim që të punojmë me to dhe duhen braktisur fjalët që i kundërshtojnë ato (tekste).

*Jo çdo kundërshtim merret në konsideratë
Përpos kundërshtimit që e ka fatin e arsyes.*

4-Nuk lejohet qortimi i atij që ka gabuar në çështjet e ixhtihadit ose ka një interpretim të arsyeshëm, përkundrazi, ai shpërblehet në përpjekjen e tij në mendim edhe nëse gabon. I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Kur gjykatësi gjykon dhe jep mund, nëse ia qëllon,

ka dy shpërblime, nëse gjykon e gabon, ka vetëm një shpërblim”⁵².

Unë apeloj te të gjithë vëllezërit e mi selefi në veçanti që të jenë zemërgjerë nëse një vëlla u kundërvihet në një çështje ixhtihadije sipas këndvështrimit të tij dhe ta dini se s’ka mundësi t’i bashkojmë të gjithë në një fjalë në të gjitha meseletë dhe ndodhitë ixhtihadije optimale, ku ka fleksibilitet për këndvështrim. Andaj, të gjithë e kanë për obligim që ta ngushtojnë maksimalisht kornizën e divergjencës, posaçërisht kur dihet se disa divergjenca janë të fryra dhe të zmadhuara.

8) Butësia.

Përdorimi i butësisë në raport me të gjitha çështjet dhe meseletë është një edukatë madhështore. Allahu, qoftë i lavdëruar dhe i lartësuar, “është i Butë dhe e do butësinë në çdo punë⁵³” dhe “vërtet s’ka vend ku vihet butësia, veçse e zbukuron dhe nga ku largohet, e shëmton⁵⁴”. Pa dyshim se Allahu “në butësi begaton atë që nuk e jep në vrazhdësi dhe në gjërat e tjera⁵⁵”.

⁵² Transmetojnë Buhariu (7352) dhe Muslimi (1716) nga Amër ibnul Asi, radijAllahu anhu.

⁵³ Transmetojnë Buhariu (6927) dhe Muslimi (2593) nga Aishja, radijAllahu anha.

⁵⁴ Transmeton Muslimi (2594) nga Aishja, radijAllahu anha.

⁵⁵ Transmeton Muslimi (2593) nga Aishja, radijAllahu anha.

Pastaj, butësia është një edukatë madhështore me të gjithë njerëzit, qoftë edhe me jobesimtarët. Hebrenjtë një ditë i thanë Pejgamberit, alejhi selam: -Vdekja qoftë mbi ty! Pejgamberi, alejhi selam, u tha: -Edhe mbi ju! Aishja, radijAllahu anha, tha: -Edhe mbi ju qoftë, edhe mallkimi! Dhe tha: -O i Dërguar i Allahut, a nuk i dëgjove se ç'thanë?! Ai tha: -Edhe unë thashë: -Edhe mbi ju!⁵⁶

Kështu që nëse Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka nxitur në butësi me ata hebrenj, a nuk është më mirë për ne ndjekësit e së njëjtës metodologji të ecim në këtë edukatë dhe të jemi të butë njëri me tjetrin e ta mëshirojmë njëri-tjetrin?!

9) Larg padrejtësisë dhe tekave dhe i drejtë me kundërshtarin.

Sigurisht që kërkuesi i dijes, i cili është i drejtë me vëllezërit e vet, është ai që largohet nga interesat vetjake, tekat, egoja dhe pëlqimi me veten. Ai nuk i shtyp padrejtësisht vëllezërit e vet, as nuk u bën padrejtësi me fjalë e me vepra, as nuk ua keqinterpretton (shtrembëron) fjalët, meqë divergjenca në mendim nuk duhet të prishë dashurinë, por prishja ndodh nga divergjenca kur të zotin e saj e shoqëron padrejtësia dhe zullumi. Allahu i Lartësuar thotë: **“Ata të cilëve u është dhënë Libri, patën mospajtime nga zilia që kishim**

⁵⁶ Transmetojnë Buhariu (6024) dhe Muslimi (2165) nga Aishja, radijAllahu anha.

midis tyre, vetëm pasi u erdhi dituria” (Alu Imran: 19). Allahu i Lartmadhëruar urdhëroi drejtësi edhe ndaj jobesimtarëve kur tha: **“O ju që besuat! Bëhuni plotësisht të vendosur për hir të Allahut, duke dëshmuar të drejtën, dhe të mos ju shtyjë urrejtja ndaj një populli e t’i shmangeni drejtësisë; bëhuni të drejtë, sepse ajo është më afër devotshmërisë”** (Maide: 8).

Hoxha i Islamit Ibën Tejmije, rahimehullah, thotë: “Ky ajet është shpallur për shkak të urrejtjes së tyre ndaj jobesimtarëve dhe është urrejtje e urdhëruar, mirëpo nëse në urrejtjen për të cilën ka urdhëruar Allahu i zoti i saj është ndaluar që t’i bëjë padrejtësi atij që e urren, atëherë ç’të thuhet për urrejtjen e muslimanit për një interpretim, dyshim ose tekë vetjake?! Ky është më prioritar që të mos i bëhet padrejtësi⁵⁷”.

Kjo do të thotë se kërkuesi i dijes i drejtë i llogarit gjërat mirë dhe nuk i rrit më shumë se ç’janë realisht, as nuk e stërmadhon gabimin, por e përmend atë ashtu siç është, nëse e kërkon nevoja për ta përmendur, gjithnjë duke e respektuar vëllain e vet gabimtar dhe pa e akuzuar atë pa kurrfarë shkakut të arsyeshem, si dhe duke e pasur në konsideratë kujdesin për rrethanat që e kanë shpënë në atë gabim.

⁵⁷ “Minhaxhus Sunneh en Nebevije” (5/127).

Allahu të ruajt, shiko tregimin e sahabit të ndershëm Hatib ibën Ebi Belteah⁵⁸, radijAllahu anhu, se si Pejgamberi, alejhi selam, ia pranoi arsyetimin dhe e quajti besnik dhe Allahu ia fali atë gabim për shkak të besnikërisë së tij dhe se ishte nga luftëtarët e Bedrit. Ai, Allahu qoftë i kënaqur me të, e kishte interpretuar veprën e vet dhe nuk kishte për qëllim miqësimin e jobesimtarëve, assesi, ndaj Allahu e thirri me emrin e besimit kur tha: **“O besimtarë, mos i bëni miq armiqtë e Mi dhe tuajit”** (Mumtehine: 1), edhe pse gabimi që kishte bërë, ishte i rrezikshëm në të vërtetë.

Pastaj sipas këtij shembulli krahaso edhe të tjerët.

Ibën Kajimi, rahimehullah, ka thënë: “Nga rregullat dhe urtësitë e shariatit gjithashtu është se ai që ka punë të mira shumë dhe të mëdha, si dhe ka ndikim të dukshëm në Islam, arsyetohet me gjëra që të tjerët nuk arsyetohen dhe i falet për gjëra që të tjerëve nuk u falen, sepse është e vërtetë që mëkati është i fëlliqur, por kur uji arrin sasinë e madhe, nuk e bart fëlliqësirën⁵⁹”. Kjo është gjë e njohur te njerëzit dhe e mbjellë në natyrshmërinë e tyre, se kush ka me mijëra të mira, ai falet për një apo dy gabime, siç thuhet:

*Nëse i dashuri vjen me një faj,
Të mirat e tij vijnë me mijëra ndërmjetësues.*

⁵⁸ Transmeton Buhariu (3983, 6259, 6939) nga Aliu, radijAllahu anhu.

⁵⁹ “Miftahu daris seadeh” (1/176).

10) Studimi i librave të devotshmërisë, të cilat shërojnë sëmundjet e zemrave.

S'do mend se zemrat e robërve sëmuren ashtu si sëmuren trupat dhe ndryshken ashtu si ndryshket hekuri. Allahu i Lartësuar thotë: **“Atyre në të vërtetë nuk u janë verbuar sytë, por u janë verbuar zemrat e veta në kraharor”** (Haxh: 46), ndërsa i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Vërtet në trup është një copë mishi, nëse ajo është në rregull, i tëri trupi është në rregull, e nëse ajo prishet, prishet i tërë trupi, e ajo është zemra⁶⁰”.

Prandaj, nëse dëshirojmë mbrojtjen e zemrave nga mllefi, urrejtja, zilia, zullumi e egoja dhe nëse dëshirojmë t'i mbajmë nën kontroll shpirtit nga devijimi, atëherë duhet të përpiqemi maksimalisht për të gjetur shkaqet që i përmirësojnë ato zemra dhe i largojnë nga këto sëmundje, si dhe që i shtyjnë të zotët e tyre të kenë frikë Allahun dhe ta kenë parasysh mbikëqyrjen e Tij, të punojnë me atë që e kënaq Atë dhe të largohen nga hidhërimi i Tij. Kjo realizohet përmes leximit të Kuranit dhe meditimit të tij. Ibën Abdulkavij, rahimehullah, thotë: *“Mëso vazhdueshëm Kuranin sepse e zbut zemrën e ngurtë si gurë⁶¹”*.

Po ashtu kujdesi për Sunetin, meditimi dhe kuptimi i tij, leximi i librave të devotshmërisë që zbusin zemrat, si librat e Ibën Kajimit: “El Fevaid”, “Uddetus sabirin”, “Miftahu

⁶⁰ Transmetojnë Buhariu (52) dhe Muslimi (1599) nga Nuaman ibën Beshiri, radijAllahu anhu.

⁶¹ E ka shënuar Ibën Muflih në “Adabet” e tij (3/589).

daris seadeh”, “Tarikul hixhretejn”, “El Xhevab el Kafi”, pastaj librat e shejh Seadit, si libri “Shexheretul imani” e të tjerë libra të devotshmërisë që janë të pastër nga risitë dhe sufizmi, në përputhje me metodologjinë e selefus salih. Allahu i Lartësuar thotë: **“E për sa i përket atij që e ka tepruar. Dhe i dha përparësi jetës së kësaj bote. Xhehenemi do të jetë vendi i tij. E kush iu frikësua para Zotit të vet dhe ndaloi veten prej epsheve. Xheneti është vendi i tij”**. (Naziat: 37-41)

11) Marrja në konsideratë e dobive dhe dëmeve

Kush i vështron rregullat e urtësitë dhe të sheriatit, e vëren se janë disa rregulla që duhen pasur në konsideratë dhe duhet punuar me to për të ruajtur dobیتë dhe për të shmangur dëmet. Disa prej tyre janë: Largimi i dëmeve është më prioritar sesa sjellja e dobive dhe të punuarit me të keqen më të lehtë për ta larguar të keqen më të madhe” apo të themi më qartë: Përballimi i dëmit të ulët për ta shmangur dëmin më të madh.

Medito, Allahu të ruajt, për fjalën e Pejgamberit, alejhi selam, ndaj Aishes, radijAllahu anha, kur e pyeti atë rreth rindërtimit të Qabesë. Ai tha: “Po të mos ishte (fakti) që populli yt u largua nga pabesimi para pak kohe (dhe janë të rinj në Islam), do ta kisha bërë (rindërtuar)”⁶². Kur Abdullah

⁶² Transmetojnë Buhariu (1583) dhe Muslimi (1333).

ibën Zubejri, radijAllahu anhu, e morri përsipër rrëzimin e Qabesë dhe e rindërtoi në themelet e Ibrahimit, pas tij erdhi Haxhaxhi, i cili e rrëzoi sërish dhe e nxori dhomën dhe e ktheu si ishte. Kur erdhi në post Mensur El Abasi dhe deshi ta rrëzonte, u konsultua me imam Malikun, rahimehullah, i cili nuk ishte i pajtimit dhe tha: “Unë e urrej që mbretërit ta marrin këtë si lojë”, ndaj e la ashtu siç ishte dhe ashtu është deri më sot⁶³.

Po ashtu kemi edhe shembullin e të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, i cili i la munafikët dhe nuk i ndëshkoi, edhe pse ata u dekonspiruan nga Allahu dhe Pejgamberi i njihnte emrat e shumicës prej tyre, por i la në mënyrë që “*të mos thonë njerëzit se Muhamedi i vrau shokët e vet*”⁶⁴. Ai gjithashtu i shihte idhujt që rrethonin Qabënë, por nuk i largoi derisa u forcuan muslimanët me çlirimin e Mekës, atëherë i theu⁶⁵ dhe njëherazi lexonte fjalën e Allahut të Lartësuar: “**Dhe thuaj: Erdhi e vërteta e u zhduk e kota. Vërtet, e kota gjithnjë ka qenë e zhdukur**”. (Isra: 81)

Shembuj të këtillë ka shumë në zbatim të kësaj rregulle (puna me të keqen më të lehtë ose largimi i dëmeve është më prioritar sesa sjellja e dobive), ndaj puna me këtë rregull duhet të zbatohet ndaj çdo kundërshtari. Kështu që nëse

⁶³ Shih “El Bidaje ven Nihaje” i Ibni Kethirit (3/49).

⁶⁴ Transmetojnë Buhariu (4905) dhe Muslimi (2584) nga Xhabir ibën Abdilahi, radijAllahu anhuma.

⁶⁵ Transmetojnë Buhariu (4720) dhe Muslimi (1781) nga Abdullah ibën Mesudi, radijAllahu anhu.

refuzimet ndërmjet kërkuesve të dijës çojnë në dëmin më të madh, të cilin e shfrytëzojnë armiqtë e Sunetit, atëherë është obligim këshillimi i ndërsjellë për ta sqaruar të vërtetën me argument dhe për ta shëruar çdo problematikë sipas rrethanave, duke mos e harruar faktin e ruajtjes së pozitës së atij që i bëhet refuzimi.

Gjithashtu meditoni, Allahu ju ruajt, për trajtimin nga ana e dijetarëve të Sunetit i librave të Ibën Haxherit e Neveviut, Allahu i mëshiroftë, dhe i librave të dijës të të tjerëve (ku autorët kanë bërë gabime jo të pakta, por edhe keqinterpretime), por ata e trajtonin me refuzim gabimin duke ia ruajtur pozitën dijetarëve. Për shembull lexo vërejtjet e shejhut tonë shejh Abdulaziz bin Bazit, rahimehullah, ndaj “Fet’hul Barit”, vërejtje të cilat sqarojnë gabimet e hafidh Ibën Haxherit, rahimehullah, në çështje të besimit, por duke e pasur në konsideratë vlerën dhe pozitën e tij të madhe.

Ibën Kajimi, rahimehullah, thotë: “Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, e ka ligjësuar për umetin e tij obligueshmërinë e refuzimit të së keqes, në mënyrë që të arrihen të mirat që i do Allahu dhe i Dërguari i Tij, mirëpo nëse refuzimi i asaj të keqeje sjell domosdoshmërisht një të keqe më të madhe dhe më të urryer tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, atëherë nuk lejohet refuzimi i asaj (të keqeje) edhe nëse Allahu e urren atë dhe të zotët e saj⁶⁶”.

⁶⁶ “Palamul muvekkîn” (3/12).

Pra, nëse refuzimi (kritika) çon në një të keqe më të madhe, duhet ndaluar dhe pritur, bile duhet ndaluar refuzimi krejtësisht. Allahu i Lartësuar thotë: **“Mos i shani idhujt që ata i adhurojnë në vend të Allahut, në mënyrë që ata të mos e shajnë Allahun armiqësisht nga padija”**. (Enam: 108)

Ibën Tejmije, rahimehullah, thotë: “Nëse nuk gjendet drita e kulluar, por gjendet vetëm drita e përzier (me errësirë), pa të cilën njeriu do të mbetet krejtësisht në errësirë, atëherë njeriu nuk duhet të qortohet për këtë përdorim të dritës me errësirë dhe të ndalohet nga ajo, veçse nëse sigurohet drita e plotë pa errësirë⁶⁷”.

Sa e sa dritë daveti është shuar, sa e sa interes i thirrjes është humbur për shkak të ngutjes dhe paralajmërimit që është bërë kundër thirrësve të sinqertë dhe kërkuesve të dijes selefij, përmes të cilëve ishte e mundur që Allahu të bënte dobi me dijen e tyre dhe t’ia ndriçonin shoqërisë rrugën, sikur të mos shuhej ajo dritë! Por ato barriera dolën në rrugë nga disa kërkues dije të vegjël, injorantë të mashtruar, të cilët ndoqën këtë shteg skandaloz e të turpshëm dhe si pasojë shkaktuan prishje duke hamendësuar se janë përmirësues!

Me këtë rast po përmend shprehjen e shejhut tonë, shejh Alij bin Nasir el Fekihi, gjatë diskutimit të një koke të fraksionit “Ithvanul muslimin” me të cilët u takuam në vitin 1402 hënor gjersa ishim në Kano të Nigerisë, ku si

⁶⁷ “Mexhmu’ul fetava” (10/364).

përfundim u tha: “Nëse ne posedojmë një ndërtesë me mangësi, a thua e largojmë krejtësisht, që të ndërtojmë godinë mbi rrënojat e saj apo përiqemi për plotësimin e mangësive?!” Pastaj u tha atyre: “Pa dyshim që thirrja juaj i ngjason atij që ndërton në ajër pa kurrfarë themeli. Allahu thotë: **“Cili është më i mirë, ai që themelet e godinës së vet i vë në përkushtimin ndaj Allahut dhe në kënaqësinë e Tij apo ai që themelet e godinës së tij i vë në bregun e gjërryer dhe që rrokulliset me të në zjarrin e xhehenemit?! Allahu nuk e udhëzon në rrugë të drejtë popullin keqbërës”**. (Tevbe: 109)

Atëherë, o thirrës të Islamit dhe të Sunetit, meditoni për këtë kuptim dhe zbatoheni e mos e shkatërroni ndërtesën për shkak të një metodologjie që e keni përvetësuar ju, por bëhuni pjesëmarrës me vëllezërit tuaj në ndërtimin e kësaj godine në bamirësi dhe devotshmëri dhe kini frikë Allahun!

12) Kuptimi i fjalës së përcjellë siç ishte qëllimi i thënësit dhe siguria nga besnikëria e përcjellësit

Pa dyshim që disa nga naivitetet, refuzimet, kritikrat dhe kushtëzimet që po ndodhin në horizontin e daveit janë për shkak se disa nuk i kuptojnë fjalët e thënësve sipas qëllimit të thënësit ose për shkak të moskuptimit të atij që po i flitet, ose si rezultat se po teprohet në besnikërinë e disa përcjellësve.

*Për sa refuzues të një fjale të saktë
Defekti i tyre është kuptimi i gabuar.*

Kështu që kërkuesi i dijes, i përkushtuar ndaj së vërtetës, nuk ngutet në pranimin e lajmeve nga psherëtimat derisa ta kuptojë qëllimin e thënësit dhe saktësinë e lajmit dhe kuptimin e gjuhës dhe qëllimit të tij, pra derisa t'i përfshijë të gjitha këndet. E kur të merret me kritikim, kritikimi i tij duhet të jetë i qëlluar dhe i mbështetur në argument, duke pasur në konsideratë dobinë dhe dëmin që vijnë nga ai lajm i transmetuar.

*Ata ma referuan mua atë që nuk e foli me gojën time
E meta e lajmeve nuk qëndron veçse te transmetuesit.*

Për këtë arsye Ibën Tejmije, rahimehullah, ka thënë: “Shumica e transmetuesve të lajmeve nuk kanë për qëllim të gënjejnë, por njohja reale e fjalëve të njerëzve pa i transmetuar tekstualisht dhe çdo gjëje që mundëson të kuptohen fjalët e tyre e bën të kuptuarit e drejtë të qëllimit të folësit të vështirë, e për disa edhe të pamundshëm⁶⁸”. Kërkuesi i dijes kur t'i vijë ndonjë lajm, e ka për obligim që:

- ta vërtetojë saktësinë
- të mos përcjellë çdo lajm që i vjen
- të mos transmetojë nga çdo përcjellës.

⁶⁸ “Minhaxhus sunneh en nebevije” (6/303).

Jahja ibën Meini, rahimehullah, ka thënë: “Kur të shkruash, përmblihdh (nga të gjitha anët), e kur të flasësh, zgjidh (çka po flet)⁶⁹”.

Para së gjithash, fjala e Allahut të Lartësuar thotë: **“O besimtarë! Nëse ndonjë njeri i pandershëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë (në është i vërtetë), për të mos i bërë dëm ndokujt pa dashje, e të pendoheni pastaj për atë që keni bërë”**. (Huxhurat: 6)

Dhe: **“O besimtarë! Kur të shkoni në luftë, në rrugë të Allahut, shqyrtoni gjithçka me kujdes! Mos i thoni atij që ju përshëndet me selam: “Nuk je besimtar”**. (Nisa: 94)

Qëllimi me “sigurohuni” është të njohësh mirë, të kuptosh mirë dhe të kesh maturi e të mos ngutesh, derisa të qartësohet çështja mirë dhe të duket haptazi. Kjo duhet të ndodhë te lajmi dhe përcjellësi. Sa i përket lajmit, kjo bëhet duke e vërtetuar besnikërinë e përcjellësit të lajmit dhe se nuk ka turpe. Për këtë shkak Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Sa pretendim i keq i njeriut është (shprehja) ‘kanë thënë⁷⁰’”. Hatabiu, rahimehullah, ka thënë: “Për shprehjen ‘kanë thënë’, ajo thuhet për lajmin që nuk ka zinxhir fare, as nuk është e saktë, por flitet nëpër njerëz duke e zmadhuar, ndaj Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, e

⁶⁹ “Es Sijer” (11/85).

⁷⁰ Transmeton Ahmedi në Musned (17075), Buhariu në “Edebul mufred” (763), Ebu Davudi në Sunenin e tij (4972) dhe të tjerët nga Ukbete ibën Amër el Bedrii, radijAllahu anhu, dhe e saktësoi Albani në “Silsile Sahiha” (866).

ka qortuar lajmin që ka këtë rrugë dhe urdhëroi që të konfirmohet dhe të vërtetohet për atë që flitet, në mënyrë që të mos flitet vetëm se pasi t'i referohet saktësisë dhe i përcjellë nga njeriu besnik⁷¹”.

Ibën Tejmije, rahimehullah, thotë: “Kush dëshiron ta përcjellë një fjalë nga një grup, le ta citojë me emër thënësin dhe përcjellësin (e asaj fjale), përndryshe secili ka mundësi të gënjejë⁷²”.

13) Mos u mashtro nga ndjekësit e shumtë

Allahu i Lartësuar thotë: “**Nëse i bindesh shumicës së njerëzve që gjenden në tokë, ata do të të shmangin nga rruga e Allahut**” (Enam: 116). Dhe: “**Shumica e njerëzve, sado që të dëshirosh ti, nuk janë besimtarë**”. (Jusuf: 103)

Disa individë mashtrohen nga ndjekësit e shumtë dhe vartësit e tyre e pastaj mendojnë se janë bërë dijetarë të mençur dhe njerëz të rëndësishëm e të famshëm, kurse në anën tjetër kanë frikë se ndjekësit mos u largohen dhe bëhen ndjekës të dikujt tjetër, nëse nuk u nënshtrohen dëshirave të tyre e nuk u përshtaten mendimeve të tyre.

Në anën tjetër, ndjekësit e tij mashtrohen dhe trazohen nga ai, për pasojë nuk ndjekin të vërtetën që gjendet te të tjerët, edhe nëse ky që ndjekin është në të kotën.

⁷¹ “Mealimus Sunen” (4/130).

⁷² “Minhaxhus Sunneh en Nebevije” (2/518).

Kjo është një çështje e rrezikshme në të cilën bien shumica e shtiakëve të dijes me ndjekësit e tyre, të cilëve nuk u intereson gjë veçse tubimi i njerëzve rreth tyre, duke u mashtruar me “rregullin” shumica e madhe!

Kjo është në kundërshtim me udhëzimin e Kuranit dhe të Sunetit dhe të rrugës së selefit, ngase shumica e pakica nuk janë shenja që aludojnë për të vërtetën, meqë e vërteta është një dhe nuk është e shumtë në numër dhe se e vërteta e meriton që të pasohet, edhe nëse njerëzit e kundërshtojnë. Kështu që kini kujdes, o të dashurit e mi kërkues dije, nga mashtrimi me ndjekësit e shumtë sepse mund të jetë vetëm: **“...si mirazhi në shkretëtirë, të cilin i etshmi e kujton për ujë, por kur arrin tek ai vend, nuk gjen asgjë”**. (Nur: 39)

14) Mendimi i mirë për vëllain tënd musliman është obligim

Dije se në parim muslimani është i pastër nga qortuesi, përderisa nuk e dëshmon të kundërtën e kësaj të mbështetur me argument. Allahu i Lartësuar thotë: **“O besimtarë! Largoni shumë dyshime, se vërtet disa dyshime janë gjynah”** (Huxhurat: 12). Dhe thotë: **“Ata ndjekin vetëm hamendjet dhe atë që ua ka qejfi”** (Nexhm: 23). I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, thotë: **“Kujdes nga paragjykimet, sepse paragjykimi është fjala më e**

rreme⁷³!” Dhe: “I mjafton njeriut si gënjeshtër që të flasë me gjithçka që dëgjon⁷⁴”. Umer ibën Hatabi, Allahu qoftë i kënaqur me të, ka thënë: “Për një fjalë që del nga muslimani mos e mendo për keq, përderisa mund t’i gjesh asaj (fjalës) interpretim të mirë”⁷⁵.

O të dashurit e mi, kërkues dije, largoni dyshimet (e paragjykimet) dhe fjalët e vëllezërve tuaj interpretojini për mirë, mos i këputni ato dhe mos spekuloni për ta të pathënën, mos i kushtëzoni me detyrim, se ke pasur për qëllim këtë, kurse ata nuk e kanë pasur për qëllim, por zbatoni fjalën e mësipërme të Umerit, radijAllahu anhu: “Për një fjalë që del nga muslimani mos e mendo për keq, përderisa mund t’i gjesh asaj (fjalës) interpretim të mirë”.

15) Kush vjen me të vërtetën, pranoje prej tij

Kërkuesi i dijes i përkushtohet së vërtetës dhe i bindet asaj, edhe nëse e ka thënë kundërshtari. Ja ku e ke Ebu Hurejrën, radijAllahu anhu, duke e miratuar të vërtetën e thënë nga shejtani, kur i tha: “Kur të shkosh në shtrat, lexo ajetul

⁷³ Transmetojnë Buhariu (5143) dhe Muslimi (2563) nga Ebu Hurejra, radijAllahu anhu.

⁷⁴ Transmeton Muslimi në Sahihun e tij (1/10) nga Ebu Hurejra, radijAllahu anhu.

⁷⁵ “Revdatul ukala” (90).

kursinë, bile Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, tha: “Të vërtetën ka thënë, edhe pse ai është një gënjeshtar⁷⁶”.

Shpjegimi i kësaj është se Ebu Hurejra, radijAllahu anhu, nuk e ka pranuar të vërtetën nga shejtani, por e ka pranuar atë vetëm pasi e lajmëroi Pejgamberin, alejhi salatu ves selam, për thënien e tij dhe Pejgamberi, alejhi salatu ves selam, ia vërtetoi.

Kurse në fjalën e Pejgamberit, alejhi salatu ves selam, “*të vërtetën e ka thënë, edhe pse ai është një gënjeshtar*”, ka refuzim ndaj atyre që thonë se ne e marrim dijen nga kushdo qoftë pa merak dhe pa asnjë kusht, por ne e pranojmë të vërtetën dhe (njëherazi) e refuzojmë të kotën! Ebu Hurejra nuk kërkoi dije nga shejtani, por e vërtetoi pas vërtetimit të të Dërguarit të Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, përndryshe ai (iblisi) është gënjeshtar që nuk i zihet besë, siç është gjendja e shumicës së ndjekësve të tekave. Prandaj, fillimisht dija nuk merret nga ata, e nëse nga ata buron një shprehje që është në pajtim me të vërtetën, atëherë e pranojmë duke respektuar të vërtetën e jo ata.

Njëherë një prift (i hebrenjve) kishte shkuar tek i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, dhe i tha: -O Muhamed! Ne e kemi gjetur se Allahu mund t’i bëjë qiejt e tokat të jenë në një gisht dhe drurin në një gisht, edhe ujin, edhe dheun e imët në një gisht dhe të gjitha krijesat e tjera në një gisht dhe thotë: “Unë jam Sunduesi?”. Pejgamberi,

⁷⁶ Transmeton Buhariu (2311) nga Ebu Hurejra, radijAllahu anhu.

alejhi salam, qeshi derisa iu shfaqën edhe dhëmballët në shenjë vërtetimi të asaj që tha prifti, pastaj i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, lexoi (nga Kurani): **“Ata nuk e kanë vlerësuar siç duhet fuqinë e Allahut. Në Ditën e Kiametit e tërë Toka do të jetë në grushtin e Tij, ndërsa qiejt do të mbështillen në të djathtën e Tij. Qoftë i lavdëruar Ai dhe i lartësuar mbi idhujt që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)”**. (Zumer: 67)⁷⁷

Po ashtu një prift kishte shkuar te Pejgamberi, alejhi salam, dhe i tha: “Ju po bëni shirk (idhujtari)! Po thoni: Çka do Allahu dhe çka do ti, dhe po thoni: Pasha Qabenë!” Atëherë i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, tha: “Thoni: Çka do Allahu e pastaj çka do ti dhe thoni: Pasha Zotin e Qabesë⁷⁸”.

Abdullah ibën Mesudi, radijAllahu anhu, tha: “Kush të vjen ty me të vërtetën, pranoje prej tij, edhe nëse është i largët dhe e urren, ndërsa kush të vjen me të kotën, refuzoja atë atij, edhe nëse është i afërt dhe i dashur⁷⁹”.

⁷⁷ Transmetojnë Buhariu (4811) dhe Muslimi (2786) nga Abdullah ibën Mesudi, radijAllahu anhu.

⁷⁸ Transmetojnë Ahmedi në Musnedin e tij (28093), Nesaiu në Sunenin e tij (3773), Hakimi në Mustedrekun e tij (7815) dhe të tjerët nga Kutejle bint Sajfi, radijAllahu anha, dhe e saktësoi Albani në “Silsile Sahiha” (136).

⁷⁹ Transmetojnë Bageviu në “Sherhus Sunneh” (1/234) dhe Ebu Nuajmi në “Hilje” (1/134) dhe njësoj është transmetuar edhe nga Ubej ibën Keabi, radijAllahu anhu, shih “El Hilje” (9/121).

16) Përdorimi i sinjaleve dhe këshillave në vend të skandalizimit, akuzës, nëse mjaftojnë për të korrigjuar gabimin dhe larguar të keqen

Përkujtoje me mua, Allahu të ruajt, udhëzimin e Pejgamberit, alejhi selam, në përkujtimin e të rinjve që deshën të bëjnë punë nga mendja e tyre në kundërshtim me Sunetin dhe dihet se sikur ta kishin bërë, do të kishin rënë në bidat dhe këtë e vërteton fjala e Pejgamberit, alejhi selam: “Ç’është puna e **disave** që kanë thënë kështu e ashtu? Por, unë falem dhe fle, agjëroj dhe ha, edhe martohem me gra, ndaj kush e kundërshton Sunetin tim, ai nuk është nga unë⁸⁰”.

Aishja, radijAllahu anha, duke përshkruar udhëzimin e Pejgamberit, alejhi selam, tha: “Kur i arrinte ndonjë lajm për dikë, nuk thoshte: Ç’është kështu puna e **filanit**?”, por thoshte: “Ç’është puna e **disave** që po thonë kështu e ashtu?!⁸¹”

Këtë e mbështet rregulli: Moszbulimi i gabimtarit është obligim në çështjet ku nuk ka rrezik, çështje të cilat nuk detyrojnë paralajmërimin nga ai.

I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: “Kush ia fsheh një muslimani (gabimin), Allahu ia fsheh atij

⁸⁰ Transmetojnë Buhariu (5063) dhe Muslimi (1401) nga Enes ibën Maliku, radijAllahu anhu.

⁸¹ Transmetojnë Ebu Davudi në Sunenin e tij (4788), Bejhakui në “Shuab” (7745), Tahaviu në “Muxhkilel Athar” (5881) dhe të tjerët nga Mesruku, rahimehullah, dhe e saktësoi Albani në “Es Sahiha” (2064).

në Ditën e Kiametit”⁸². Dhe: “Njerëzve (të devotshëm apo shëmbëlltyrë) me përgjegjësi faljani gabimet (nëse u ndodh ndonjë gabim i vogël)”⁸³. Si dhe: “Kush ia fal një muslimani, Allahu ia fal atij gabimin në Ditën e Kiametit”⁸⁴.

Këtu duhet të tërheqim vërejtjen se përmendja e emrit të gabimtarit është gjë e kërkuar patjetër nëse ai është i njohur me çështjen e tij dhe është thirrës në gabimin dhe shpikjen e tij, por edhe interesi e kërkon që të përmendet me emër. Këtë e dëshmon edhe fjala e Pejgamberit, alejhi selam, kur i tha Fatime bint Kajsit, radijAllahu anha, kur kjo i kërkoi atij këshillë meqë Muavi bin Ebi Sufjani dhe Ebu Xhehmi ia kishin kërkuar dorën. Ai, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, tha: “Sa i përket Ebu Xhehmit, ai nuk e largon shkopin e tij nga qafa e vet, kurse Muaviu është i varfër, nuk ka pasuri”⁸⁵. Dhe po ashtu fjala e tij, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, kur një person kërkoi leje të hynte tek ai dhe e dinte gjendjen e tij, tha: “Lëreni të hyjë, sa njeri i keq është ai!”⁸⁶

Imam Neveviu, rahimehullah, ka thënë: “Ky hadith na mëson mirësjelljen me atë njeri prej të keqes së të cilit ruhesh dhe lejimin e përgojimit të mëkatarit që e bën

⁸² Transmetojnë Buhariu (2442) nga Abdullah ibën Umeri, radijAllahu anhu, dhe Muslimi (2590) nga Ebu Hurejra, radijAllahu anhu.

⁸³ Transmetojnë Buhariu në “Edebul mufred” (465), Ebu Davudi në Sunenin e tij (4375), Nesaiu në “Sunen el Kubra” (7253) dhe të tjerët nga Aishja, radijAllahu anha, dhe e saktësoi Albani në “Silsile Sahiha” (683).

⁸⁴ Transmetojnë Ibën Maxheh në Sunenin e tij (2199), Ebu Davudi në Sunenin e tij (3460), Hakimi në Mustedrek (2291) dhe të tjerët nga Ebu Hurejra, radijAllahu anhu, dhe e saktësoi Albani në “Irvaul Galil” (1334).

⁸⁵ Transmeton Muslimi në Sahihun e tij (1480).

⁸⁶ Transmetojnë Buhariu (6054) dhe Muslimi (73) nga Aishja, radijAllahu anha.

mëkatin haptazi dhe të atij prej të cilit njerëzit duhen paralajmëruar”.⁸⁷

Nuk duhet harruar të theksohet se disa ithtarë të bidatit nuk duhet të përmenden me emrat e tyre, në mënyrë që të mos bëhen të famshëm te njerëzit, meqë janë të panjohur, kurse përmendja e tyre me emra i afirmon.

17) Është e domosdoshme që kërkuesit e dijes të udhëzohen në preokupimin me dije dhe mësim, me arsimim në fenë e Allahut të Lartësuar dhe përpjekja në kuptimin e Kuranit dhe Sunetit sipas metodës së të parëve tanë të mirë, larg teprimi dhe neglizhencës, në mënyrë që të shpëtojnë nga ky ngatërrim, ndasi, urrejtje reciproke, armiqësi dhe lëçitje.

Kjo është për shkak se u morën me gjëra për të cilat nuk janë të zotë, e Allahu e ka mëshiruar atë që ia di hallin vetes. Kurrsesi nuk u lejohet atyre të merren me shkencën e hadithit “*xherb* dhe *teadil*” para se ta zotërojnë këtë shkencë dhe të jenë ekspertë të rregullave të saj.

Ndërsa shndërrimi i kësaj shkence në një çështje me të cilën merret kushdo, saqë edhe injorantët apo edhe të rinjtë që vetëm sa kanë hyrë në Islam, kjo vërtet është një çështje shumë e rrezikshme, ku disa kërkues të vegjël dije e zbatojnë (*xherbin*) jashtë kornizave të metodës së të parëve tanë të mirë –*selefus salih*.

⁸⁷ “Komenti i Muslimit” (16/144).

Prandaj, e kemi detyrim që këtë çështje t'ua lëmë dijetarëve edukatorë, të cilët janë ekspertë të këtij zanati, në vend që të atillët të zhyten aty ku nuk kanë ekspertizë. Kështu e vërteta kthehet në vendin e vet dhe luani kthehet në mbretërinë e tij, në mënyrë që mos të rrëshqasë këmba pas qëndrimit e pastaj të pendohet kur nuk bën dobi pendimi”.

Fjalët e disa dijetarëve të ndershëm bashkëkohorë rreth rregullave që i japin fund mospajtimit

Këtu më duhet të kujtoj disa rregulla për të cilat mendoj se zbatimi i gabueshëm i tyre sot ishte shkaku esencial i asaj që ndodhi nga urrejtjet reciproke mes ndjekësve të një rruge dhe këtë po e bëj shkurtimisht, pa e zgjatur.

Po i paraprij me citimin e disa fjalëve të disa dijetarëve bashkëkohorë të çmuar, të cilët kanë aluduar për shumicën e rregullave të Sunetit.

Nga të parët e tyre është imami, alameja shejh Abdulaziz ibën Bazi, rahimehullah, i cili ka thënë: “Si rezyme themi se sheriatit i përsosur erdhi me porosinë për të punuar me butësi në vendin e vet dhe me vrazhdësi në vendin e vet, kështu që nuk i lejohet muslimanit t’i injorojë këto e as nuk duhet ta vendosë butësinë në vendin e vrazhdësisë e as vrazhdësinë në vendin e butësisë. As nuk i duhet atribuar sheriatit se porositi vetëm me butësi, ose me vrazhdësi vetëm, por është legjislacioni i urtë, i përsosur dhe i mirë për çdo kohë dhe vend dhe për përmirësimin e umetit. Sheriatit ka ardhur me të dyja porositë duke u shquar me drejtësi, urtësi dhe lehtësi, pra është i lehtë në dispozitat e tij dhe nuk ngarkon me atë që s’mund të bëhet. Faktikisht sheriatit në thirrje ia fillon me butësi e urtësi, por nëse këto nuk kanë ndikim dhe njeriu i kalon kufijtë e vet dhe e tepron, atëherë e merr me fuqi, vrazhdësi dhe e trajton me atë që e zbraps

dhe e njofton mirë me veprën e tij të keqe. Kush mediton për jetën e Pejgamberit, alejhi selam, dhe të kalifëve të tij udhëzues e shokëve të tij të kënaqur me ta si dhe të imamëve të udhëzimit pas tyre, e kupton saktësinë e kësaj që përmendëm.

Tekstet që urdhërojnë për butësi në vendin e vet:

Nga ajetet që citojnë butësinë në fjalën e Allahut të Lartësuar: **“Nga mëshira e Allahut u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj, falua gabimin, kërkoi falje Allahut për ta dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme”** (Alu Imran: 159). Dhe fjala e Allahut në tregimin e Musait dhe Harunit, kur i dërgoi te faraoni: **“Flitini atij fjalë të buta, se ndoshta kujtohet a frikësohet”** (Ta Ha: 44). Dhe fjala e të Lartësuarit: **“Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë!”** (Nahl: 125)

Tekstet që aludojnë për përdorimin e ashpërsisë në vendin e vet janë disa nga ajetet e ashpërsisë të përmendura më herët⁸⁸.

Nga hadithet përmendim atë që kanë transmetuar Ahmedi dhe Ebu Davudi e të tjerët nga Ibni Mesudi, radijAllahu anhu, se Pejgamberi, alejhi selam, kur lexoi fjalën e të

⁸⁸ Shejh Bin Bazî, rahimehullah, në fillim të shkrimit kishte sjellë ajetet: Et Tevbe: 73, 123 dhe Ankebut: 46.

Lartësuarit: **“Ata izraelitë që ishin mohues, u mallkuan me gjuhën e Davudit dhe të Isait, të birit të Merjemes, për shkak se kundërshtonin, shkelnin çdo kufi. Dhe nuk e ndalonin njëri-tjetrin të bënin vepra të këqija. Eh, sa të shëmtuara ishin veprat që bënin ata!”** (Maide: 78-79)

Dhe: *“Pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti im, do të urdhëroni për mirë dhe do të ndaloni nga e keqja dhe do ta kapni për dore mendjelehtin!”*

Në një transmetim tjetër: *“Do ta kapni për dore zullumqarin dhe do ta këshilloni derisa të drejtobet, ose do jeni neglizhente në këshillimin e tij me të vërtetën, e pastaj Allah do t’ju përçajë zemrat dhe pastaj ju mallkon ashtu siç i mallkoi të mëbershit”⁸⁹.*

Ndërsa nga Ebu Hurejra, radijAllahu anhu, transmetohet se Pejgamberi, alejhi selam, ka thënë: *“E kam menduar të urdhëroj që të thirret për namaz, pastaj ta urdhëroj dikë që t’ua fal namazin njerëzve dhe më pas të nisem me disa burra duke marrë me vete drurë dhe të shkoj tek ata që nuk marrin pjesë në namazin me xhemat e t’ua djeg atyre shtëpitë”⁹⁰.* Në një transmetim ka thënë: *“Sikur të*

⁸⁹ Transmetojnë Taberaniu në “Mu’xhemul kebir” (10267), Bejhakui në “Shuabul iman” (7139) dhe Ibën Vedah në “El Bideu” (267) dhe të tjerët nga Abdullah ibën Mesudi, radijAllahu anhu, dhe e saktësoi Albani në “Sahihul Xhami” (2398).

⁹⁰ Transmetojnë Buhariu (2420) dhe Muslimi (651).

mos ishte se nëpër shtëpi janë gratë dhe fëmijët, do t'ua kisha djegur (shtëpitë)⁹¹”.

Kurse në koleksionin e Muslimit nga Ibni Mesudi, radijAllahu, transmetohet se i Dërguari i Allahut ka thënë: “Çdo Pejgamber që Allahu e ka dërguar para meje te një umet, nga umeti i tij kishte ndihmës dhe shokë që ndiqnin sunetin e tij dhe zbatonin urdhrin e tij. Pas tyre erdhën breza që flisnin atë që nuk e vepronin dhe vepronin atë për të cilën nuk ishin të urdhëruar. Kush i lufton këta me dorën e tij, ai është besimtar. Kush i lufton ata me gjuhën e tij, ai është besimtar e kush i lufton ata me zemrën e tij, ai është besimtar, kurse pas kësaj nuk ka besim as sa kokrra e sinapit⁹²”. Ndërsa tregimi i atyre të treve që nuk shkuan në betejën e Tebukut pa asnjë justifikim është i njohur te njerëzit e dijes. Pejgamberi, alejhi selam, me shokët e tij, Allahu qoftë i kënaqur me ta, i bojkotoi (ata tre) për pesëdhjetë net derisa u penduan, atëherë Allahu ua pranoi atyre pendimin dhe për këtë zbriti fjala e Tij, qoftë i lartësuar: **“Pa dyshim, Allahu e pranoi pendimin e të Dërguarit, të muhaxhirëve dhe të ensarëve, të cilët shkuan pas atij në çastin e vështirë”** deri te fjala e Tij: **“Ai ua pranoi pendimin edhe atyre të treve”**. (Tevbe: 117-118)

⁹¹ Transmeton Ahmedin në Musnedin e tij (8796) nga Ebu Hurejra, radijAllahu anhu.

⁹² Transmeton Muslimi (50).

Nga kjo që u përmend prej ajeteve dhe haditheve shkruesi dhe lexuesi e kupton mirë se sheriati islam i plotësuar ka ardhur me butësinë në vendin e vet dhe me ashpërsinë në vendin e vet⁹³”.

Ai, rahimehullah, në një vend tjetër, pasi përmend tekstet që ndalojnë nga mendimi i keq për muslimanin, thotë: “Por, kjo e tëra nuk është pengesë që të këshillohet gabimtari nga radhët e dijetarëve ose thirrësve në fe në ndonjë punë të tyre, qoftë thirrje apo veprimtari, përkundrazi, duhet të orientohet kah e mira, të udhëzohet kah e vërteta me metodë të mirë e jo me thumbime, paragjykime e metodë të dhunshme. Kjo e largon nga e vërteta më shumë sesa e fton në të dhe për këtë Allahu i Lartmadhëruar u tha dy të Dërguarve të Tij, Musait dhe Harunit, kur i dërgoi te krijesa më mohuese në kohën e vet: **“Flitni atij fjalë të buta, se ndoshta kujtohet a frikësohet”**. (Ta Ha: 44)

Allahu i Lartësuar po ashtu na lajmëroi se me çfarë e ka pajisur atë natyrshmërisht prej butësisë, urtësisë dhe afërsisë në thirrje dhe tha: **“Nga mëshira e Allahut u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje”**. (Alu Imran: 159)

Ai, qoftë i lavdëruar, e urdhëroi atë që të ftonte në rrugën e Zotit të vet me urtësi dhe këshilla të bukura, kur tha: **“Thirr**

⁹³ Mbaroi sqarimi i shejh Bin Bazit, rahimehullah, shih “Mexhmu’ul fetava” (3/20-207).

në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë” (Nahl: 125). Por, kjo nuk është e veçantë vetëm për Pejgamberin, alejhi selam, por është urdhër i drejtuar atij dhe të gjithë dijetarëve të umetit dhe për çdo thirrës në të vërtetën sepse urdhrat e Allahut për Pejgamberin e Tij, alejhi selam, nuk janë ekskluzive për të, por përfshijnë umetin në tërësi, me përjashtim të asaj ku argumenti aludon se është ekskluziv për të.

Allahu i Lartësuar thotë: **“Tek i Dërguari i Allahut ka një shembull të mrekullueshëm”** (Ahzab: 21), dhe për shkak të fjalës së Tij, të Lartmadhëruarit: **“Pra, ata të cilët e besojnë atë, e nderojnë dhe e ndihmojnë, veprojnë me dritën që iu zbrit me të, të tillët janë të shpëtuarit”** (Araf: 157), dhe fjala e Tij: **“Allahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve dhe prej ensarëve dhe prej atyre që i pasuan ata me punë të mira, e edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. Atyre u ka përgatitur xhenete, në të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përjetë të pasosur. E ky është fitim i madh”**. (Tevbe: 100)

Nga i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, transmetohet se ka thënë: *“Kush privohet nga butësia, është privuar nga tërë mirësitë⁹⁴”,* dhe tha: *“Nuk ka vend ku e vë*

⁹⁴ Transmeton Muslimi (2592) nga Xherir ibën Abdullahu, radijAllahu anhu, pa fjalën “tërë”, edhe pse kjo është e saktë, e ka saktësuar Albani në “Sahihul Xhami” (6606).

butësinë, veçse zëbukurohet dhe nga ku hiqet, veçse e shëmton atë”⁹⁵. Ai tha po ashtu: “*Pa dyshim se Allahu jep përmes butësisë atë që nuk e jep me dhunë*”⁹⁶.

Hadithe të tjera të shumta aludojnë se thirrësit në Allah, qoftë i lavdëruar, dhe këshilluesit e njerëzve e kanë obligim që të zgjedhin metodat e dobishme dhe shprehjet në të cilat nuk ka as dhunë e as largim nga e vërteta, metoda nga të cilat shpresohet që kundërshtuesit e së vërtetës t’i binden asaj dhe ta pranojnë e të jenë të kënaqur me të si dhe ta lënë prapa të kotën. Thirrësit e kanë obligim që të mos ndjekin rrugë të cilat i largojnë të tjerët nga e vërteta dhe ftojnë në refuzim dhe mospranim”⁹⁷.

Gjithashtu në një vend tjetër thotë: “Sa i përket metodës së thirrjes, këtë e ka shpjeguar Zoti i Madhërishëm dhe kjo është thirrja me urtësi, dije dhe vigjilencë, me butësi dhe lehtësi, e jo me ashpërsi e vrazhdësi. Kjo është metoda shariatike në thirrje, përveç atij që bën shtypje, pasi kush është shtypës, trajtohet me atë që meriton, kurse kush e pranon thirrjen dhe i bindet asaj apo shpreson nga ai pranimin e saj, meqë nuk ka replikuar e as nuk ka bërë padrejtësi, me këtë sillu butë. Allahu i Madhërishëm në Librin e Tij fisnik thotë: “**Thirr në rrugën e Zotit tënd me urtësi** (*hikmeh*) **dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë!**” (Nahl: 125). Dhe urtësia është

⁹⁵ Transmeton Muslimi (2594) nga Aishja, radijAllahu anha

⁹⁶ Transmeton Muslimi (2593) nga Aishja, radijAllahu anha.

⁹⁷ “Mexhmuul fetava” (27/462) të Bin Bazit, rahimehullah.

dituria: “ka thënë Allahu, ka thënë Pejgamberi alejhi selam”. Këshilla e bukur është inkurajimi dhe frikësimi, duke sqaruar se sa mirësi të mëdha ka në bindjen ndaj Allahut dhe hyrjen në Islam si dhe çfarë pasojash ka nëse tregohet kryeneç dhe nuk e pranon të vërtetën e të tjera. Diskutimi në mënyrën më të mirë, ka për qëllim shpjegimi i argumenteve pa ashpërsi në rast të dyshimeve në mënyrë që të hiqen dhe zbulohen ato. Kështu që gjatë diskutimit diskuton me mënyrën më të bukur, duke treguar durim dhe përmbajtje sikurse citohet në ajetin tjetër: **“Diskutoni me ithtarët e Librit vetëm me mënyrën më të mirë, por jo me keqbërësit e tjerë”** (Ankebut: 46). Keqbërësit kanë tjetër trajtim, mirëpo përderisa ke mundësi të diskutosh me më të bukurën dhe ai e pranon atë dhe e dëgjon, ose flet me diçka që nuk konsiderohet keqbërës e as shtypës, atëherë duro dhe përmbaju me këshilla dhe argumente sheriatike dhe diskutim të bukur. Allahu i Lartësuar thotë: **“Thoni njerëzve fjalë të mira”** (Bekare: 83), kurse Pejgamberi, alejhi selam, ka thënë: *“Bamirësia është morali i bukur”⁹⁸*. Allahu e ka lavdëruar Pejgamberin, alejhi selam, për çështjen e thirrjes kur i tha: **“Nga mëshira e Allahut u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje”** (Alu Imran: 159). Pejgamberi ynë është njeriu më i plotësuar në thirrje, njeriu më i plotësuar në besim, por sikur të ishte i ashpër dhe i vrazhdë, njerëzit do të largoheshin prej tij dhe do ta braktisnin, po ty?! Kështu që duro shumë, përmbahu dhe mos nxito me sharje apo fjalë të

⁹⁸ Transmeton Muslimi (2553) nga Nevas ibën Semani, radijAllahu anhu.

këqija ose vrazhdësi. Në anën tjetër, përmbaju butësisë e mëshirës dhe sjelljes së qetë. Allahu kur e dërgoi Musain dhe Harunin te faraoni, çfarë u tha atyre të dyve? U tha: “**Flitni atij fjalë të buta, se ndoshta kujtohet a frikësohet**” (Ta Ha: 44); kështu vepro edhe ti, ndoshta shoku yt kujtohet dhe frikësohet.

Në kolecionin e Muslimit⁹⁹ nga Aishja, radijAllahu anha, transmetohet se Pejgamberi, alejhi selam, ka thënë: “*O Allahu im, kujt i jepet diçka nga udhëheqja e umetit tim dhe tregohet i butë me ta, edhe Ti trajtoje me butësi atë! O Allahu im, kujt i jepet diçka nga udhëheqja e umetit tim dhe ai ua vështirëson atyre, edhe Ti vështirësoja atij*”, e ky është një premtim i madh në përdorimin e butësisë dhe kërcënim i madh për përdorimin e vrazhdësisë. Ai, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, tha: “*Kush privohet nga butësia, është privuar nga e tërë mirësia*”¹⁰⁰ dhe: “*Tregohuni të butë sepse nuk ka vend ku e vë butësinë, veçse zbukurohet dhe nga ku hiqet, veçse e shëmton atë*”¹⁰¹.

Thirrësi në Allah e ka për obligim që të durojë dhe të përdorë metodën e butë gjatë thirrjes së tij ndaj muslimanëve apo edhe mohuesve, patjetër duhet të ketë butësi me muslimanin dhe me jobesimtarin, edhe me prijësin dhe me të tjerët, e posaçërisht me prijësit, kryetarët dhe personalitetet, meqë ata kanë nevojë më shumë për butësi

⁹⁹ Transmeton Muslimi (1228).

¹⁰⁰ Transmeton Muslimi (2592).

¹⁰¹ Transmeton Muslimi (2594).

dhe metodë të bukur, se ndoshta e pranojnë të vërtetën dhe i japin prioritet para çdo gjëje.

E njëjta gjë vlen edhe për atë tek i cili është mbjellë bidati dhe gjynahu dhe i kanë kaluar vitet në të. Duhet durim i madh për t'ua larguar bidatin me argumente, derisa t'i shpjegohet e keqja e mëkatit dhe pasojat e saj të tmerrshme; kështu e pranon nga ti të vërtetën dhe e braktis mëkatin¹⁰²".

Shejh Muhamed Musa¹⁰³, rahimehullah, ka thënë: "Shejh Bin Bazit, rahimehullah, kishte metodë të dalluar me kundërshtarët. Ai ecte përmes teksteve të sheriatit të pastër, të cilat urdhërojnë për tolerancë dhe falje, largim të së keqes me të bukurën si dhe kthim të së keqes me të mirë dhe distancë nga çdo gjë që bie ndesh me drejtësinë, duke e respektuar kundërshtimin. Metodologjia e shkëlqesisë së tij me kundërvajtësin ishte se ai nuk i interpretonte fjalët e tyre në atë që nuk nënkuptohet (interpretohet), as nuk spekulonte për ta, as nuk i përmendte me të keq e as nuk i akuzonte, por i respektonte ata dhe i çmonte, ua harronte qëllimisht fajet e tyre karshi hakut të tij (nëse i kishin hyrë në hak shejhut), i pranonte justifikimet e atyre që arsyetoheshin tek ai, posaçërisht të atyre që kishin punë të mira të moçme dhe që ishin njerëz me vlerë. E kur e vizitonte dikush nga kundërshtarët e tij, shejhu shfaqte gëzim, falje dhe kujdes të

¹⁰² "Mexhmuul fetava" (6/416-418) të shejh Bin Bazit, rahimehullah.

¹⁰³ Ishte drejtues i mektebit të Shejh Bin Bazit, Allahu i mëshiroftë të dy.

shtuar ndaj tij, shfaqte edhe dashuri ndaj tij dhe ngrohtësi me qëllim të përmirësimit dhe afrimit të tij¹⁰⁴”.

Shejh Muhamed Musa kishte përmendur disa shembuj nga shkëlqesia e tij për sa i përket butësisë së tij me kundërshtarët e tij me shpresë të udhëzimit të tyre, por prej tyre po përmend qëndrimin e shejhut ndaj Muhamed Gazalit:

Shejh Musa, rahimehullah, rrëfen: “Kur shejh Muhamed Gazali, rahimehullah, erdhi në Riad për të marrë çmimin e ofruar nga Komisioni i Çmimit Botëror të Mbretit Fajsal, ai vizitoi shejhun në shtëpinë e tij dhe në këtë kohë ishte bërë shumë zhurmë rreth librit të shejh Gazalit “Suneti pejgamberik mes dijetarëve të fikhut dhe të hadithit”, libër ky që i ishte lexuar shejhut të nderuar. Kur e vizitoi, shejhu e priti me ngrohtësi të madhe, e respektoi dhe u tregua i butë me të dhe e pyeti për thirrjen në fe në Algjeri dhe nevojat e tyre dhe i shprehu gatishmërinë më të madhe për t’i mbështetur ata, pasi në atë kohë shejh Gazali ishte drejtues i një universiteti në Algjeri. Si zakonisht, ndejat e shejh Bin Bazit ishin plot me vizitorë, pyetës, nevojtarë e mysafirë dhe zilja e telefonit nuk ndalej kurrë, kurse shkruesit rreth shejhut lexonin... Sa herë që shejhut i jepej mundësia, kthehej nga shejh Gazali dhe i shprehte mikpritje dhe butësi. Gazali u magjeps nga ky mozaik dhe kjo vërehej tek ai, ndërkohë që shejh Bin Bazi i tha shejh Gazalit: -E kam

¹⁰⁴ Fragmente nga jeta e Imam Abdulaziz bin Bazit, rahimehullah (277), të Muhamed Ibrahim el Hamed.

përmendur librin tënd të përfolur dhe besoj që e ke të qartë se njeriu i ekspozohet gabimit. Edhe ne edhe të tjerët nuk shpëtojmë nga gabimi. Unë kam lexuar diçka nga libri yt, por janë disa vërejtje në të. Shejh Gazali tha: -Unë gëzohem nëse e vazhdoni leximin e tij dhe pastaj të më dërgoni vërejtjet tuaja dhe unë, nëse do Allahu, do t'i përmirësoj... dhe diçka të ngjashme. Ndërkohë, gjersa shejhu i përgjigjej një telefonate, filloj një diskutim mes shejh Gazalit dhe njërit nga dijetarët prezentë, e ky ishte shejh Hajrudin Vanilij nga Siria. Shejh Hajrudini i tha: -Ju keni thënë kështu e ashtu, kurse Gazali iu kthye atij me kundërshtim dhe u ashpërsua diskutimi. Kur shejh Bin Bazi i dëgjoi ata të dy, u kthye nga Gazali dhe pyeti se çfarë kishin. Ai tha kështu e ashtu. Atëherë shejhu u foli të gjithëve se këto çështje duhet të vendosen në kornizat e veta e të jemi të kujdesshëm shumë për unitetin e fjalëve tona dhe t'u largohemi mospajtimeve, meqë ne gjendemi para disa çështjeve madhore që kanë të bëjnë me themelet e çështjeve... pastaj qetësoi hidhërimin e atyre të dyve dhe përfundoi debati. Shejh Gazali ishte i ftuar në një drekë tjetër, por ai u vonua për atje qëllimisht dhe ndenji te shejhu dhe hëngri drekë së bashku me shejhun. Kur u ngrit për t'u larguar, shikoi edhe njëherë nga shejhu i nderuar (Bin Bazi) dhe tha: -Ne do të jemi mirë, përderisa ky burrë është në mesin tonë. Dhe pastaj e mora vesh se kur Gazali ishte pyetur nga ata te të cilët shkoi, se përse ishte vonuar, u kishte thënë: -Ishim në një botë tjetër!"¹⁰⁵

¹⁰⁵ Fragmente nga jeta e Imam Abdulaziz bin Bazit, rahimehullah (280).

Shejhu, rahimehullah, ka edhe qëndrime të tjera që nuk mund të numërohen.

Shejhu ynë, dijetari i madh Dr. Salih Fevzani, Allahu e ruajt, është pyetur: -Allahu çoftë mirësi mbi ju, a keni ndonjë këshillë të begatshme për t'ua drejtuar djemve dhe vëllezërve tuaj nga kërkuesit e dijes të umetit islam në përgjithësi?

Ai u përgjigj: -Ju këshilloj që të keni frikë Allahun, të vazhdoni në kërkim të dijes me kujdes të madh, të punoni me atë që ua ka mësuar Allahu dhe të thirrni për tek Allahu i Madhëruar. Mësojuni njerëzve atë që mësuat për vete dhe lërin grindjet që ndodhin mes kërkuesve të dijes, sharjet e ngacmimet mes tyre që çuan në përçarje të umetit dhe i ndanë kërkuesit e dijes duke thënë “paralajmëro nga filani, mos u ul me fistekun, mos lexoni para filanit...”. Kjo nuk lejohet. Nëse një person i caktuar ka gabim, e këshillon në vetmi, por ta shpërndash këtë mes njerëzve dhe të paralajmërosh prej tij gjersa ai është një dijetar ose kërkues dije, apo njeri i devotshëm, por ja që ka gabuar, kjo nuk lejohet të shpërndahet. Allahu thotë: **“Ata, të cilët dëshirojnë që te besimtarët të përhapet imoraliteti, ata i pret një dënim i dhembshëm në këtë botë dhe në tjetrën; Allahu i di (të fshehtat) e ju nuk i dini”**. (Nur: 19)

Këshillimi i ndërsjellë mes muslimanëve është i detyrueshëm, dashuria reciproke është detyrim, e posaçërisht mes kërkuesve të dijes si dhe mes dijetarëve, meqë duhen

respektuar dijetarët dhe nuk duhet ta akuzojnë njëri-tjetrin dhe të mos paralajmërojnë njëri kundër tjetrit. Ky është një shkak i të këqijave të shumta, shkak i grindjeve dhe urrejtjeve, shkak i trazirave.

Largohuni nga këto punë, Allahu ju shpërbleftë, dhe bëhuni ashtu si do Allahu: **“Kjo fe është e juaja dhe është e vetmja fe (e shpallur)”** (Enbija: 92), dhe: **“Mos u bëni si ata që pasi u erdhën provat e qarta, u përçanë dhe u grindën. Për këtë do të ketë dënim të madh”** (Alu Imran: 105). Jini të kujdesshëm për të bashkuar, punoni për këshilla të ndërsjella mes jush, kujdesuni për bashkëpunim në bamirësi dhe devotshmëri dhe ruajuni gjërave që i përçajnë muslimanët, posaçërisht në këtë kohë. Muslimanët sot kanë nevojë për bashkim, kanë nevojë të ndalin mosmarrëveshjet mes tyre, kanë nevojë për bashkëpunim në bamirësi dhe devotshmëri, mos u bëni ndihmës të armikut për shkapërderdhjen e muslimanëve dhe përçarjen e tyre. Nëse ndodh plasaritja mes dijetarëve dhe mes kërkuesve të dijes, atëherë kush i mbetet umetit?! Në këtë rast, populli i thjeshtë nuk kanë faj, por faji është i kërkuesve të dijes sepse është obligim i tyre që të mësojnë njerëzit, të bëjnë përmirësime në mesin e tyre, ndaj lërinini këto gjëra, këto urrejtje të ndërsjella, këto injoranca dhe këto vese të këqija! Allahu thotë: **“Mos e përgojoni njëri-tjetrin! Vallë, a dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?!”** (Huxhurat: 12). Dhe thotë: **“Por ti mos iu bind çdo betuesi të përçmuar. Shpifësi që përhap thashetheme. Penguesi veprash të mira, shkelësi dhe keqbërësi”**

(Kalem: 10-12). Njerëzve të tillë mos u nënshtroni, mos u bëni ndihmës të shejtanit në përçarjen e umetit dhe dobësimin e tij, por tek ai që gjeni defekte, këshilloni, nëse defektet janë të konfirmuara, por mos u besoni thashethemeve! Allahu thotë: **“O besimtarë! Nëse ndonjë njeri i pandershëm ju sjell ndonjë lajm, sigurohuni mirë (në është i vërtetë), për të mos i bërë dëm ndokujt pa dashje, e të pendoheni pastaj për atë keni bërë”** (Huxhurat: 6). Dhe thotë: **“O besimtarë! Kur të shkoni në luftë, në rrugë të Allahut, shqyrtoni gjithçka me kujdes! Mos i thoni atij që ju përshëndet me selam: “Nuk je besimtar”.** (Nisa: 94)

Allahu i Lartmadhëruar ka nxitur për bashkimin e muslimanëve dhe unifikimin e fjalës së tyre, ka nxitur për bashkëpunim dhe këshilla të ndërsjella. Ne nuk themi “lëreni gabimin”, por **përmirësojeni** gabimin me rrugë legjitime. Allahu i dhëntë sukses të gjithëve në atë që Ai i do dhe kënaqet me të! Paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi Pejgamberin tonë, Muhamedin, dhe mbi të gjithë shokët e tij¹⁰⁶.

Shejhu i nderuar Salih Alu Shejhu, Allahu e ruajt, u pyet: -Cili është qëndrimi i muslimanit për gabimet e disa thirrësve?

¹⁰⁶ Fundi i “Komenti i librit të agjërimit nga “Delilut talib”, 24 Shaban, 1434.

Ai -Allahu i dhëntë sukses- u përgjigj: “Më e mira është që kjo çështje t’u lihet njerëzve të dijes, ngase preokupimi i të rinjve me këtë lloj çështjesh sjell probleme mes tyre. Është e vërtetë që tërheqja e vërejtjes nga gabimet është gjë e kërkuar, mirëpo nuk duhet të jetë preokupimi ynë kryesor refuzimi i gabimeve të filanit e fistekut. Nuk është ky tipar i njerëzve të dijes, ndaj edhe Ibën Kajimi në “Medarixhus Salikin” thotë: “Zemra e cila ecën drejt Allahut i ngjan atij që ecën në rrugën e mbushur me shtazë të egra, gurë dhe gjëra prej të cilave ka frikë aty e këtu. Nëse vazhdon ecjen dhe nuk kthehet, do të mbërrijë, por nëse për çdo çast kthehet anash dhe gjuan me gurë çdo gjë që i del para, ashtu nuk do të mbërrijë”. Për këtë arsye sheh se në jetëshkrimin e dijetarëve madhësia e shpjegimit të tyre të fesë është shumëfish më e madhe sesa madhësia e kritikave që u kanë bërë. Nëse llogarit cilindo dijetar se sa ka shpjeguar nga feja, do të shohësh se ka shkruar për shembull dy mijë faqe dhe ka incizuar dy mijë kasete, që nëse i krahason me madhësinë e kritikave ndaj kundërshtarëve, do të shohësh se këto të fundit (kritikat) janë shumë pak. Po, duhen kritikuar, por jo që të jetë preokupimi yt kryesor sepse patjetër duhet punuar për përhapjen e fesë dhe sqarimin e saj. Pastaj disa njerëz përmirësohen me këshilla personale e disa me sqarime dhe refuzime shkencore, por themeli i kësaj është rregulla e urdhërimit në të mirë dhe ndalimit nga e keqja sipas rastit”.¹⁰⁷

¹⁰⁷ Nga revista kuvajtiane “El Enbau”, më 19 Rebiuth-thani 1433 hënor.

Ndërsa dijetari i madh, shejh Abdulmuhsin El Abbad El Bedër, Allahu e ruajt, tha: “Pa dyshim që *ehlu suneti* e kanë për obligim që në çdo kohë dhe vend të bashkohen dhe ta mëshirojnë njëri-tjetrin si dhe të bashkëpunojnë në bamirësi dhe devotshmëri. Ajo që na bën të ndihemi keq në këtë kohë është ajo çka po ndodh nga radhët e disave të ehlu sunetit prej ashpërsisë dhe mospajtimeve, të cilat si pasojë i kanë preokupuar ata kundër njëri-tjetrit me akuza, paralajmërime e bojkotime. E kërkuara e detyrueshme ka qenë që përpjekjet e tyre të jenë të bashkuara e të drejtuar karshi të tjerëve nga radhët e mohuesve e risimtarëve nga armiqtë e ehlu sunetit. Ishte e kërkuar detyrimisht që të jenë unik dhe të mëshirshëm duke e përkujtuar njëri-tjetrin me butësi dhe lehtësi¹⁰⁸”.

Shejh Rebij ibën Hadi, Allahu e ruajt, thotë: “Unë po e them këtë nga sot, por e kam theksuar kur e kam parë këtë shkatërrim dhe këtë sprovë. Po them: Silluni butë, lehtë dhe ruani vëllazërinë e mëshironi njëri-tjetrin. Kjo ashpërsi iu drejtua vetë ehlu sunetit atëherë kur u bënë neglizhentë ndaj risimtarëve dhe ia mësynë ehlu sunetit me këtë ashpërsi shkatërruese. Si pasojë rrodhi padrejtësia dhe gjykimet e kota shtypëse, ndaj kurrsesi mos e ndiqni këtë shteg që po ju

¹⁰⁸ “Rifkan ehlu Suneti bi Ehli Suneh”, 10-11.

shkatërron dhe po e dëmton davetin selefij dhe ithtarët e saj¹⁰⁹!”

Në një vend tjetër ai tha: “Personin që tregohet neglizhent nuk e rrëzojmë e as nuk e dëmtojmë, edhe atë që gabon nga radhët tona nuk e dëmtojmë, por e përmirësojmë me butësi dhe urtësi dhe i shprehim atij dashuri, afërsi dhe moralet e tjera të mira, me thirrje korrekte derisa të pendohet. Edhe nëse tek ai akoma mbetet dobësi, nuk ngutemi kundër tij me gjykime, përndryshe, pasha Allahun, nuk do të mbetet askush, askush nuk do të mbetet!

Disa njerëz tani po i përndjekin selefitë, saqë arritën edhe te dijetarët dhe po i quajnë të paqëndrueshëm. Tani vështirë se gjen ndonjë alim në horizont që nuk është akuzuar e kritikuar dhe kjo pa dyshim është rruga e fraksionit “Ihvanul muslimin”, udha e njerëzve të tekave, sepse nga armët e tyre është të fillojnë me rrëzimin e dijetarëve. S’ka dyshim se kjo është rruga e hebrenjve masonë: Nëse dëshiron të rrëzosh një ideologji, rrëzoji dijetarët apo personalitetet e saj! Kështu që ikni nga kjo trashëgimi e shëmtuar dhe respektoni dijetarët”¹¹⁰.

Në një vend tjetër po ashtu tha: “Unë e di që ju nuk jeni të mbrojtur nga gabimet, as dijetarët nuk janë të mbrojtur, mund të gabojmë, veçse nëse personi futet në shiizëm, ose bëhet mutezili, ose xhehmij ose futet në ndonjë fraksion nga

¹⁰⁹ “Mexhmu’u kutub ve resail shejh Rebij” (1/475).

¹¹⁰ Burimi i sipërm (1/481-482).

fraksionet bashkëkohore, kjo është e papranueshme. Ndërsa me selefium që miqëson selefite dhe e do metodologjinë selefite dhe i urren fraksionet, i urren risitë dhe ithtarët dhe ka shenja të tjera të kësaj metodologjie, pastaj dobësohet në disa pika, me këtë duhet të sillemi butë dhe mos ta braktisim, por e këshillojmë dhe durojmë me të derisa ta përmirësojmë. Nuk thuhet se kush gabon, u shkatërrua! Kështu nuk ka për të mbetur askush! Ata që bëjnë këso veprimesh, kur e përfunduan punën me të rinjtë, filluan me dijetarët për t'i rrëzuar¹¹¹". Ai po ashtu tha: "Çdokush që bie në risi nuk shpallet risimtar, meqë sikur ne të punonim me këtë rregull, do t'i shpallnim risimtarë shumicën e imamëve të umetit! Hoxha i Islamit Ibën Tejmije, rahimehullah, thotë: "Shumica e imamëve të selefite dhe halefite kanë rënë në bidate pa e vërejtur fare ose për shkak që janë mbështetur në ndonjë hadith të pasaktë, ose për shkak se e kanë kuptuar ndonjë citat jashtë qëllimit të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, ose për shkak të ndonjë konkluze (ixhtihadi)". Tani ne kemi imamë muxhtehidë, por ixhtihadi i dikujt e ka shpënë në ndonjë gabim ose risi. Nëse e dimë metodologjinë e tij të shëndoshë, qëllimin e mirë, distancimin nga tekat dhe kujdesin i tij për t'ia qëlluar së vërtetës, nëse këto i dimë për të dhe pas kësaj ai bie në risi, ky person nuk shpallet risimtar. Mirëpo, nëse është e kundërta, ndjekja e tekave, qëllimi i keq dhe dimë për të gjëra të tjera që aludojnë se ai ka për qëllim risinë, ky është ai që konsiderohet risimtar. Për këtë arsye gjen se kanë gjykuar për shumë njerëz se janë risimtarë,

¹¹¹ Po aty (1/482-483).

kurse shumë prej njerëzve kishin vetëm gabime dhe nuk i quajtën ashtu, sepse e dinin qëllimin e tyre të shëndoshë, nijetin e tyre të mirë, kujdesin e tyre për t'ia qëlluar së vërtetës si dhe metodologjinë e tyre korrekte në të cilën ecnin¹¹²”.

Vëllai ynë shejhu i nderuar Ubejd ibën Abdilah el Xhabirij, Allahu e ruajt, thotë: “Ehlu suneti e kanë traditë të shikojnë te lloji i kundërshtimit dhe kundërshtuesi, kështu që lloji i kundërshtimit nuk shpëton nga dy gjendje:

1) Do të jetë kundërshtim në një fushë që nuk pranon ixhtihadin, qoftë në themelet e fesë ose në degët e tij, ngase është çështje rreth së cilës janë transmetuar tekste të shumta nga Kurani, Suneti dhe konsensusi i umetit, ose ka dispozitën e ixhmait, kurse kundërshtuesi nuk ka tekste që forcojnë drejtimin e tij.

2) Kundërshtimi ka ndodhur në një fushë që pranon ixhtihadin ose në çështje që tekstet rreth saj janë në konsideratë.

Kështu që lloji i parë, i cili nuk pranon ixhtihadin, mospajtimi rreth tij është i papranueshëm dhe gabimi duhet refuzuar, kushdo qoftë thënësi i tij.

¹¹² Kasete “Xhelsetun fil Harexh”.

Pastaj kundërshtari nuk shpëton nga të qenët njëri prej dy personave:

1) Është ndjekës i Sunetit, i njohur te njerëzit për qëndrueshmërinë e tij dhe mbrojtjen e Sunetit dhe të njerëzve të Sunetit. Ky person nuk përndiqet për gabimin e tij dhe respektohet nderi i tij, edhe nëse ia refuzojmë kundërvajtjen e tij, mirëpo ne tregohemi të edukuar me të, e nderojmë dhe nuk e turpërojmë siç turpërohen risimtarët e lajthitur, në mënyrë që t'ia ruajmë pozitën që ia ka dhënë Allahu për shkak të vlerave të tij të kahmotshme, pozitën e tij të lartë dhe prijësinë në fe. Ne krejt këto ia kemi në konsideratë dhe nëse vështron shumicën e imamëve të fesë që janë në Sunet, njerëzit dëshmojnë për mirësi sa ishin të gjallë e ashtu shpresojnë të jenë edhe pas vdekjes inshaAllah. Te këta kanë rrjedhur gabime dhe kanë pasur lëshime dhe bashkëkohësit e tyre dhe ata që erdhën pas tyre ua refuzuan ato gabime, por këtë e bënë duke ua ruajtur atyre nderin dhe duke mos i qortuar me fjalë të këqija¹¹³”.

Ndërsa vëllai ynë akademiku Sulejman ibën Selim Ruhejli, Allahu e ruajt, tha: “Pa dyshim që dija merret nga të mëdhenjtë dhe duke pasur rekomandime, por kush janë këta të mëdhenjtë? Të mëdhenjtë janë ata që dija e tyre i ka bërë të mëdhenj, janë njohur me dije edhe nëse me moshë janë të vegjël, edhe nëse janë të rinj, meqë kishte sahabë të mëdhenj

¹¹³ Ligjërata me titull: “Rregullat e raporteve me ehlu sunetin”.

(në vlerë) që ishin të vegjël në moshë dhe merrej dija prej tyre dhe dija e tyre e ndriçoi botën. Kjo çështje ka një peshë të madhe dhe realiteti i saj është se të voglin mund ta bëjë të madh dija e tij, duke u njohur me dijen e tij të rrënjësor e të dobishme dhe ky ishte realiteti i shumë selefëve që nga sahabët, Allahu i qoftë i kënaqur me ta, e deri pas imamëve. Mirëpo, ka nevojë për rekomandim, meqë dija është fe dhe ne duhet të shikojmë se nga kush po e marrim fenë tonë, por si ndodh rekomandimi? Rekomandimi ndodh përmes tri gjërave:

1-Fjalët e dijetarëve me peshë për rekomandimin e tij. Ai duhet të ketë fjalë të dijetarëve ose të disave prej tyre dhe nuk e kufizojmë rekomandimin vetëm në një apo dy dijetarë, as në tre dijetarë, por mjafton një dijetar kredibil ose grumbull i tyre se filani është i rekomanduar dhe lejohet të merret dija prej tij.

2-Të jetë i njohur për punën e tij me arsimim pa ia refuzuar askush nga dijetarët. Të dihet se ai është mësues, i famshëm për këtë dhe askush nga dijetarët nuk ia ka refuzuar atij punën me arsimim. Ky është një rekomandim i heshtur, meqë nuk i përket pozitës së dijetarëve që ky të jetë nga ata që ndalohen nga arsimimi e të mos ndalojnë prej tij.

3-E fundit dhe kjo është shumë me rëndësi, kur rekomandohet nga dija që posedon, nuk ua mëson të tjerëve veçse Sunetin, aty ku është e vërteta, dhe nuk merr veçse nga dijetarët e Sunetit, i miraton librat e dijetarëve të Sunetit, as nuk ka pasur ndonjë kritikë ndaj tij nga dijetarët kredibilë e

as nuk ka pasur kundërshtime ndaj Sunetit. Këtë e ka rekomanduar dija e tij.

Nuk ka mundësi që dijetarët të njohin çdo kërkues të dijes, por shikohet dija e tij që ai përhap: A ua mëson të tjerëve Sunetin? A i respekton dijetarët e Sunetit? A i përcjell fjalët e dijetarëve të Sunetit? Nëse është i tillë, atë e ka pastruar apo rekomanduar dija e tij dhe prej tij merret dija.

Ndërsa thënia se nuk merret dija veçse nga ata që i kanë rekomanduar dijetarët me tekst, është thënie që mbyll dyert e mirësisë, meqë shumë vende kanë kërkues të dijes, që ua mësojnë të tjerëve Sunetin dhe kanë shpjegime të ehlu sunetit dhe i mësojnë aq sa dinë, por nuk bartin ndonjë rekomandim nga ndonjë dijetar i caktuar dhe nuk njihen me diçka që e prek dijen e tyre. Nëse për këta themi se nuk merret dija prej tyre, shumë vende do të mbeten pa dije e do të mbyllet dera e mirësisë e në vend të tyre pastaj njerëzit e risive do të merreshin me arsimim, kurse njerëzit e Sunetit do të pengoheshin dhe ndjekësit e Sunetit pastaj do të merrnin mësim nga risimtarët, nga interneti ose gjetiu dhe kjo nuk është as korrekte e as e qëndrueshme.

Atëherë ne themi se rekomandimet janë të nevojshme dhe nuk duhet të tregohemi të shkujdesur e pastaj ta marrim dijen nga çdokush, por rekomandimi bëhet nga:

- dorëshkrimi i një dijetari apo numër dijetarësh kredibilë të njohur me Sunet;

- bërja i njohur shumë dhe i famshëm pa ndonjë mohim të dijetarëve

- dija e saktë dhe e shëndoshë, i pastër nga çdo akuzë, dije me të cilën kërkuesi i dijes bëhet i njohur nga dhënia mësim.

S'ka dyshim se secili duhet të ndalet aty ku i përfundon dija dhe të mos flasë jashtë asaj që posedon nga dituria, pra aq sa di edhe jep mësim. Shumica e vendeve muslimane kanë nevojë për dikë që t'ua mësojë themelet e fesë, e nëse ndokush nga ehlu suneti i njeh këto themele dhe i ka përvetësuar ato, ai i mëson njerëzit, por jo të shtiret si hoxha i Islamit Ibën Tejmije! Meqë disa kërkues dije marrin një libër ose dy dhe shkojnë për të dhënë mësim, pastaj u rritet mendja dhe fillojnë të refuzojnë disa dijetarë të mëdhenj dhe nxjerrin fetva në çdo gjë dhe flasin me çdo gjë..., pa dyshim kjo është lajthitje.

Mirëpo, njeri i mirë është ai që ndalet aty ku përfundon dija e tij dhe përhap mirësinë dhe Sunetin. Nuk na lejohet të bëhemi pengesë përballë përhapjes së të mirës dhe Sunetit dhe ky ishte edhe zakoni i dijetarëve -që arritëm t'i takonim në raport me kërkuesit e dijes, si shejh Bin Bazi, rahimehullah, dhe shejh Uthejmini, rahimehullah. Ndërsa kush njihet me akuzime ndaj tij ose dijen e ka të përzier, ose është i panjohur nga të gjitha anët, prej këtij nuk merret dija, Allahu e di më së miri¹¹⁴”.

¹¹⁴ Përgjigje ndaj një pyetje që iu drejtua shejhut në Seminarin e Transaksioneve të mbajtur në qytetin Sharika, në Emirate, më 1434 h.

Gjithashtu u pyet vëllai ynë i ndershëm, akademiku shejh Dr. Muhamed Bazmuli, Allahu i dhëntë sukses: -Në këtë kohë është paraqitur një dyshim i rrezikshëm në mesin e ndjekësve të selefit. Thuhet: Sa herë që kemi besë te një shejh selefi i rekomanduar nga dijetarët -për shkak të besës sonë ndaj dijes së tij e jo për shkak të lidhshmërisë sonë me personalitetin e tij-, ai befás po diskreditohet dhe ne nuk po e dimë shkakun që të ruhemi nga gabimet e tij. Libraritë tona personale në shtëpi sa po i mbushim me fjalë dijetarësh, po i zbrazim sërish! Si t'i përgjigjemi këtij dyshimi, i cili mund të jetë si sëmundje ngjytëse, derisa t'i shpartallojë selefitë dhe të mbizotërohen nga shejtanët? Cila është këshilla juaj ndaj selefive?

Shejhu, Allahu e ruajt, përgjigjet: “Ky realitet që përshkroi pyetësi është i pranishëm, e ndiej edhe unë. Ndoshta prej asaj që e sqaron qëllimin e pyetësit po përmend:

1- Kuptimi i selefizmit dhe referimi në të nuk do të thotë që selefiu të mos bjerë në gabime, qoftë kërkues dije i vogël apo dijetar i madh, pasi Pejgamberi, alejhi selam, thotë: “Çdo bir i Ademit është gabimtar, por më i miri prej tyre është ai që pendohet¹¹⁵”.

2- Nuk trajtohet çdo gabim me trajtimin e risimtarëve dhe kjo është një çështje shumë me rëndësi. Ka dallim në këtë pikë mes selefive dhe ekstremistëve, prej tyre hadaditë, ngaqë prej asaj që u refuzohet atyre është mosdallimi mes

¹¹⁵ Shih saktësinë e tij më herët.

gabimit të selefuit dhe gabimit të ndjekësit të risisë dhe tekave dhe trajtimi i tyre njësoj tek ata!

Pasuesi i Sunetit këshillohet dhe orientohet dhe mendimi për të është se ai e pranon të vërtetën dhe kthehet në të. Kjo nuk është as dobësi e as nënçmim, por është një trimëri etike që muslimani me të e adhuron Zotin e vet, meqë e vërteta duhet pasuar.

3- Selefizmi nuk nënkupton që të mos ndodhin divergjencat mes selefive në çështje të dijes së ixhtihadit, pasi kjo ka ndodhur edhe në mesin e sahabëve, sikurse nuk nënkupton nga të qenët selefij, pasues i Kuranit dhe Sunetit sipas metodologjisë së selefus salih që të mos ketë mospajtime në çështjet e ixhtihadit. Ja ku i ke edhe katër imamët, që janë imamët e pasuesve të selefus salih, edhe mes tyre kanë ndodhur mospajtime në çështje të dijes së ixhtihadit dhe kjo është shumë mirë e ditur dhe e njohur.

4- Selefizmi nuk nënkupton që selefii të mos bjerë në sëmundjet e zemrës nga epshet e fshehta, si dashuria për famë dhe kokëfortësia me vëllezërit e tij.

5- Nuk është nga metodologjia e selefus salih kushtëzimi i njerëzve që të pasojnë vetëm një mendim, përveç të Dërguarit të Allahut, alejhi selam, posaçërisht në çështjet e ixhtihadit.

6- Ndodh që një dijetar selefii të flasë kundër një selefii tjetër dhe mund ta zgjasë refuzimin me të për shkak të ndonjë

anashkalimi, por kjo nuk nënkupton diskreditimin e tij dhe qëndrimi që duhet marrë është mendimi i mirë, kështu që ne formojmë bindje se refuzimi i atij dietari është si rezultat i një ixhtihadi që ai ka bërë dhe është kështu mes dy shpërblimeve nëse ia ka qëlluar dhe një shpërblimi nëse ka gabuar.

7- Nëse dikush flet kundër dikujt që njihet për drejtësinë dhe besnikërinë e tij, nuk pranohet fjala e akuzuesit sepse duhet sqaruar shkakun dhe duhet specifikuar akuzën, kështu që ky nuk trajtohet sikur ai për të cilin është folur parimisht ose sikur ai që nuk njihet as me drejtësi e as me besnikëri.

8- Mendimi i mirë ka prioritet, ndaj mos mendo keq për vëllain tënd musliman, përderisa ti sheh tek ai mirësi.

9- Nuk ka shenjtërim të personaliteteve dhe pyetësi, Allahu e shpërbleftë me të mira, i parapriu kësaj vërejtjeje kur tha “jo për shkak të lidhshmërisë sonë me personalitete”.

10- Jo çdokush që flitet kundër tij edhe diskreditohet e as çdo fjalë kundër dikujt nuk konsiderohet diskreditim.

11- Nuk është nga selefizimi përgjërimi për arritjen e rekomandimeve nga dietarët dhe vrapimi pas tyre, meqë muslimanin e pastron (rekomandon) dija e tij dhe vepra e tij para së gjithash. Andaj, toka nuk e bën të shenjtë askënd, as prejardhja nuk e shenjtëron askënd, por edhe akuzimi i njerëzve me diskreditim nuk e shenjtëron askënd.

12- Nuk është nga selefizmi të gëzohesh me turpet e njerëzve dhe diskreditimin e tyre dhe garimi pas këtyre punëve pa kurrfarë nevoje, që do të thotë se kërkuesi i dijes duhet t'i shmanget zhytjes në këto punë dhe t'ia lërë dijetarëve atë, në mënyrë që të mos bëhet shkaktar i ndezjes së trazirave, por duhet t'i fikë trazirat duke iu shmangur zjarrit të saj, duke treguar durim dhe mendim të mirë si dhe për këtë çështje t'u mbështetet dijetarëve. Allahu është dhënësi i sukseseve^{116!}”

Pas këtyre citateve të begatshme e të urta, të ndërtuara mbi metodën e selefinit nga këta njerëz të dijes, unë them:

Pa dyshim që mbrojtja e fesë islame duke sqaruar atë që i është mveshur asaj nga risitë dhe shpikjet është nga adhurimet më madhështore me të cilat njeriu i afrohet Zotit të vet, qoftë i lavdëruar dhe i lartësuar, ndaj konsiderohet xhihadi më me përparësi nga dy xhihadit. Ai është nga xhihadi i cili nuk ndalet deri në Ditën e Kiametit dhe konsiderohet xhihad i njerëzve të veçantë nga miqtë e Allahut, nga Pejgamberët e Tij dhe ndjekësit e tyre.

Ibën Tejmije, rahimehullah, thotë: “Refuzuesi i ithtarëve të risive është luftëtar (muxhahid), saqë Jahja ibën Jahja thoshte: “Mbrojtja e Sunetit është xhihadi më i mirë¹¹⁷”.

¹¹⁶ E marrë nga faqja zyrtare e shejhut në facebook më 16 Muharrem, 1436 h.

¹¹⁷ “Mexhmu’ul fetava” (4/13).

Mirëpo, të folurit kundër gabimtarëve të caktuar, posaçërisht atyre që i referohen Sunetit dhe ndjekësve të tij, nuk e zotëron kushdo, por duhet t'u lihet atyre që njihen për dije dhe devotshmëri.

Imam Dhehebiu, rahimehullah, ka thënë: “Të folurit për burra nuk i lejohet veçse atij që është ekspert në njohje dhe i plotësuar në devotshmëri¹¹⁸”.

Më poshtë po ju sjellim disa rregulla që i theksuam më lart:

- Gabimi refuzohet në mënyrë absolute, ndërsa refuzimi i gabimtarit ndryshon varësisht nga gjendja e tij.

Për shembull, gabimet e udhëheqësit nuk përmenden para publikut dhe nëpër minbere, por shkohet tek ai dhe i refuzohen para atij, ose korrespondon me të dhe e këshillon fshehurazi, ose mjaftohesh duke e përmendur gabimin pa e përmendur emrin e tij. I Dërguari i Allahut, sal-lallahu alejhi ve selem, ka thënë: “*Kush dëshiron ta këshillojë një sundues rreth një çështjeje, mos ta bëjë atë publikisht, por le ta kapë për dore atë dhe të vetmohet me të (për ta këshilluar). Nëse e pranon prej tij është arritur qëllimi e nëse jo, atëherë e ka larguar përgjegjësinë nga vetja¹¹⁹”.* Gabimet dhe lëshimet patjetër që u duhen sqaruar njerëzve, duhen paralajmëruar ata nga rënia në to me rrugë legjitime,

¹¹⁸ “Mizanul i’atidal” (3/46).

¹¹⁹ Transmetojnë Hakimi në Mustedrek (5269), Taberaniu në “Mu’xhemul Kebir” (1007), Bejhakui në Sunenin e tij (16660) nga Ijad ibën Ganimi, radijAllahu anhu, dhe e saktësoi Albani në “Dhilalul Xhenneh” (1097).

kurse gabimtari nëse është nga dijetarët e njohur për mirësi dhe devotshmëri, atëherë duhet këshilluar në vetmi dhe duhet ruajtur nderi i tij dhe pozita e tij te njerëzit si dhe duhet lutur për të me mirësi, udhëzim dhe përmirësim.

Ibën Tejmije, rahimehullah, thotë: “Kush njihet për ixhtihadin e tij kredibil, nuk lejohet të përmendet me qortim dhe të akuzohet me mëkatim sepse Allahu pa dyshim ia fal atij gabimin. Përkundrazi, për shkak të besimit dhe devotshmërisë së tij, ai duhet të miqësohet dhe duhet dashur si dhe t’i jepen të drejtat që Allahu ia ka dhënë, si lavdërimi i tij, lutja për të e të tjera¹²⁰”.

Kjo çështje forcohet edhe më shumë sa herë që gabimtari është më afër pozitës së dijetarëve. Dhehebiu, rahimehullah, ka thënë: “Nëse të qëlluariat e dijetarit të madh janë të shumta dhe njihet për kujdesin e tij ndaj së vërtetës, me dije të thellë, me shkathtësi të dukshme dhe njihet për devotshmërinë, modestinë dhe pasimin e tij, këtij i falen lëshimet dhe as nuk e konsiderojmë të lajthitur, as nuk hedhim poshtë e as nuk i harrojmë veprat e tij të mira, por as nuk e ndjekim në bidatin dhe gabimin e tij dhe i urojmë atij pendim për atë¹²¹”.

Po ashtu, nuk pranohet akuza e atij që e ka akuzuar e as nuk i kushtohet vëmendje, veçse pas një dëshmie dhe argumenti të qartë e të dukshëm si qartësia e diellit në mes të ditës.

¹²⁰ “Mexhmu’ul fetava” (28/234).

¹²¹ “Es Sijer” (5/271).

Ibën Abdulberri, rahimehullah, ka thënë: “Kush është vërtetuar se është njeri i drejtë dhe imamllëku e tij në dije është konfirmuar, besnikëria e tij është sqaruar bashkë me kujdesin e tij ndaj diturisë, pas kësaj nuk i kushtohet vëmendje fjalës akuzuese të askujt, vetëm nëse vjen në akuzën e tij me një dëshmi të drejtë, ku me të vërteton kritikën e tij përmes rrugëve të dëshmimeve dhe punën në to nga të shikuarit direkt, gjëra të cilat detyrojnë t’i besohet atij (akuzuesit) dhe njëherazi duhet të jetë i pastër nga smira, xhelozia, armiqtësia e konkurrenca, të gjitha këto së bashku¹²²”.

Po ashtu ai tha: “Vërtet selefi (të parët tanë të mirë), Allahu i mëshiroftë, kishin akuza kundër njëri-tjetrit, ndonjëherë nga gjendja e hidhërimit, ndonjëherë nga xhelozia (siç thanë Ibën Abasi, Malik Ibën Dinari dhe Ebu Hazim), e nganjëherë nga interpretimi që detyrimisht nuk nënkupton se thënësi ka pasur për qëllim atë nga ajo që e ka akuzuar akuzuesi, e bile disa nga ata i ngritën shpatat kundër njëri-tjetrit nga interpretimi, ixhtihadi, për të cilat këto nuk ndiqen patjetër në asgjë prej tyre pa fakte dhe dëshmi që obligojnë ndjekjen¹²³”.

Kurse Ibën Tejmije, rahimehullah, ka thënë: “Besnikëria e një personi merret vesh ndonjëherë duke e provuar atë dhe duke ndenjtur me të, e ndonjëherë me përhapjen e besnikërisë së tij te njerëzit dhe për këtë dijetarët thanë se

¹²² “Xhamiu bejanil ilmi” (2/1093).

¹²³ Po aty.

konsiderimi i dikujt si i drejtë (kredibil) nuk ka nevojë për të sqaruar shkakun, ngaqë të qenët e dikujt i drejtë, besnik, që nuk gënjen, nuk sqarohet duke përmendur diçka specifike, përkundër diskreditimit, që nuk pranohet veçse duke e specifikuar-dëshmuar detajisht, siç është e aprovuar te shumica e dijetarëve¹²⁴.

- Dallimi i trajtimit të ithtarëve të bidatit nga selefus-salih sipas gjendjes së fuqisë dhe dobësimit.

Nëse suneti është i fortë dhe i shfaqur, atëherë ata ndëshkojnë njerëzit e mëkateve dhe të risive mvarësisht prej mëkateve dhe risive të tyre, në bazë të asaj që i zbraps, dhe i ndalojnë njerëzit nga veprat e tyre, ashtu si veproi Pejgamberi, alejhi selam, me tre kundërvajtësit para se t'u zbriste atyre pranimi i pendimit nga Allahu dhe siç veproi Umeri, radijAllahu anhu, me Sabigun, këtë rrugë ndjekin edhe imamët e Islamit.

Por nëse suneti dobësohet dhe ndjekësit e tij janë si të huaj – siç është gjendja në shumicën e vendeve islame sot, e lëre më huajësinë e muslimanëve në vendet e kufrit-, atëherë ata e kanë obligim që të kenë parasysh leverdinë sheriatike në këtë çështje.

Ibën Tejmije, rahimehullah, pasi përmend se hixhreti ndonjëherë është nga devotshmëria e ndonjëherë nga

¹²⁴ “El Akidetu el Asfahanije” (200).

xhahadi dhe urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja, ai thotë: “Për këtë arsye, vendimi i shariatit dallon në dy llojet e hixhretit (migrimit): mes atij që ka mundësi (migrimin) dhe mes atij që s’ka mundësi dhe mes sasisë së paktë të llojit të bidatçitullit zullumçar dhe mes shumicës së tij, fuqisë e dobësisë¹²⁵”. Imam Ahmedi u pyet për ata që thonë se Kurani është i krijuar dhe ai, rahimehullah, tha: “Atij i bashkëngjitet çdo bela”. U tha: “A duhet ta shfaqim armiqësinë ndaj tyre apo t’i lehdatojmë?” Ai tha: “Banorët e Hurasanit janë të pafuqishëm përballë tyre¹²⁶”.

- Në lidhje me bojkotin e risimtarit duhet t’i jepet përparësi dobisë shariatike

Ibën Tejmije, rahimehullah, kur flet për rregullat e bojkotimit të risimtarit, thotë: “Nëse në bojkotimin e tij nuk përfitohet as zmbarsja e askujt e as ndalimi, përkundrazi, humbën një numër i madh të mirash të urdhëruara për t’u punuar, atëherë bojkoti nuk urdhërohet, siç e ka përmendur Ahmedi për banorët e Hurasanit, meqë atëherë ata nuk ishin të fuqishëm përballë xhehmive. Prandaj, kur janë të paaftë për të shfaqur armiqësinë kundër tyre, urdhri për ta bërë atë punë të mirë (bojkotin) anulohet dhe në sjelljen e mirë me ta ka largim të dëmit nga besimtari i dobët dhe ndoshta në këtë

¹²⁵ “Mexhmu’ul fetava” (28/211).

¹²⁶ “Mexhmu’ul fetava” (28/210).

mënyrë (sjellje të mirë) ka mundësi t'i përfitohet zemra ndonjë keqbërësi të fuqishëm¹²⁷".

Ai tha gjithashtu: "Po ashtu, kur te banorët e Basras u shumuan kaderitë, sikur të braktisej transmetimi i hadithit prej tyre, do të humbte dija, sunetet dhe gjurmët e memorizuara tek ata. Andaj, nëse pamundësohet kryerja e obligimeve nga fusha e dijes dhe xhihadit e të tjera veçse përmes atij që ka bidate, që dëmi i saj është më i vogël sesa lënia e atij obligimi, atëherë arritja e leverdisë së obligimit me një fesad të vogël së bashku është më e mirë se e kundërta (humbja e obligimit krejtësisht)¹²⁸".

Disa njerëz –dikur dhe tani- citojnë ndonjë fjalë të ndonjë imami të sunetit kundër risimtarëve dhe pastaj këtë e zbatojnë mbi këdo që ka kryer ndonjë risi, bile edhe mbi ndonjë gabim në mesele të ixhtihadit!

Ndërsa Ibën Tejmije, rahimehullah, ka paralajmëruar nga kjo dukuri duke thënë: "Shumica e përgjigjeve të Imam Ahmedit dhe të imamëve të tjerë kanë buruar nga pyetjet e pyetësit, që i pyeturi e ka njohur gjendjen e atij për të cilin është pyetur, ose ka buruar si ligjërimit për një person të caktuar që i është ditur gjendja e tij dhe në këtë rast kjo është në të njëjtin relacion me çështjet e personaliteteve të buruara nga Pejgamberi, alejhi selam, dhe vendimi i saj vihet në atë që ngjason në çështje. Disa njerëz këto i kanë marrë të

¹²⁷ Po aty.

¹²⁸ Po aty (28/212).

përgjithësuara dhe i kanë përdorur në bojkot dhe refuzim aty ku nuk janë urdhëruar me të, pra (aty) ku as nuk është obligim e as e preferuar, bile ndoshta përmes saj (bojkotit e refuzimit) kanë braktisur obligime e sunete dhe kanë vepruar të ndaluarat, kurse disa të tjerë ia kthyen shpinën asaj në tërësi, kështu që nuk bojkotuan atë që ishin të urdhëruar ta bojkotonin. Ndërsa feja e Allahut është mesatarja mes ekstremistit dhe neglizhuesit¹²⁹”.

E lus Allahun, qoftë i lavdëruar dhe i lartësuar, që punët tona t’i bëjë për hir të Tij, të qëlluara sipas rrugës së të Dërguarit të Tij, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ashtu sikurse e lus Atë që t’i bashkojë zemrat dhe t’i afrojë ato dhe ta largojë mllefën prej tyre dhe që ta ndihmojë fenë e Tij, Librin e Tij dhe Sunetin e Pejgamberit të Tij, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, si dhe t’i ndihmojë robërit e Tij besimtarë që adhurojnë vetëm Atë, ehlu sunetin dhe xhematin, t’i pajtojë ata dhe të na udhëzojë të gjithëve në udhën e drejtë, të na bëjë të mundshme të jetojmë si muslimanë dhe të na vdesë si besimtarë e të na shkruajë nga robërit e Tij të devotshëm.

Salatet dhe selamet qofshin mbi Pejgamberin tonë Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij dhe mbi ndjekësit e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Ditë e shtunë,
më 20 të xhumada eth thanije, 1436 h.

¹²⁹ Po aty (28/213).

Përmbajtja:

Vlera e thirrjes në Allah.....	12
Përsosmëria e kësaj feje	14
Ku të kthehemi gjatë mosmarrëveshjeve	15
Konfirmimi, matura dhe mosnxitimi janë obligim në nxjerrjen e vendimeve për njerëzit.....	18
Shembuj të gjykimeve të padrejta në këtë metodologji të re.....	20
Shkaqet kryesore të divergjencës mes ndjekësve të një metodologjie dhe rrugët e shërimit	24
Shkaqet kryesore të divergjencës.....	24
Rrugët e shërimit të kësaj dukurie	39
Fjalët e disa dijetarëve të ndershëm bashkëkohorë rreth rregullave që i japin fund mospajtimit.....	73

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Suhejmi, Shejh Salih

Mënjanimi i përçarjeve dhe arritja e unitetit sipas rrugës së të parëve fisnikë / Shejh Salih Suhejmi; përsht. nga arabishtja Zejd Haziri; red. Arian Koçi. – Tiranë: Qendra "Udha e besimtarëve", 2023 ... f.; ... cm.

ISBN 978-9928-4757-0-1



1.Feja islame 2. Doktrina fetare

28 -284